

## Boris Johnsoni, kryeministër i Britanisë së Madhe



Na ndiqni edhe në:  
[www.epokaere.com](http://www.epokaere.com)

facebook.com  
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABRUCH GMBH  
[www.awr-abbruch.de](http://www.awr-abbruch.de)

FLET PËR "EPOKËN E RE", XHAVIT HALITI | FAQE 4 - 5



# Dorëheqja e Haradinajt nuk ka qenë e nevojshme

- Partia Demokratike e  
Kosovës (PDK) do të  
dalë partia e parë  
në këto zgjedhje

Nënkryetari i Kuvendit të Kosovës dhe anëtari i Kryesisë së Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Xhavit Haliti, ka thënë se Ramush Haradinaj nuk ka pasur nevojë të japë dorëheqje nga pozita e

kryeministrit për një ftesë nga Gjykata Speciale. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", ai ka deklaruar se Haradinaj është dashur të shkojë në Hagë dhe të kthehet për ta vazhduar punën. Deputeti i PDK-së

është shprehur i bindur se kjo parti do të dalë fituese në zgjedhjet e parakohshme. Sipas tij, pavarësisht nëse PDK-ja do të shkojë në koalicion parazgjedhor apo jo, kandidat për kryeministër do të jetë Kadri Veseli

## Kompletimi i KQZ-së, çështje urgjente

Njohësit e çështjeve kushtetuese dhe zgjedhore, Mazllum Baraliu dhe Blerim Burjani, kanë vlerësuar se pas zhvillimeve të fundit në skenën politike kompletimi i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) është çështje urgjente. Ata i kanë bërë thirrje Gjykatës Kushtetuese që me prioritet ta shqyrtojë ankesën e subjekteve politike lidhur me ligjshmërinë e vendimit të presidentit për emërimin e anëtarëve të KQZ-së muaj më parë. Sipas tyre, në bazë të këtij vendimi presidenti duhet t'i emërojë edhe dy anëtarë të rinj të KQZ-së nga radhët e koalicionit PAN | FAQE 3



## Vetëvendosja kërkon zgjedhje të menjëhershme



**RENOVA**  
PUTZ  
Magedoni  
Xhepçisht-Tetovë  
Çurëz-Ferizaj  
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009  
+389 44 487 755  
Fax: +389 44 487 200  
Mob: +377 44 501 289  
E-mail: [renova@mt.net.mk](mailto:renova@mt.net.mk)

**PRINCESHA**  
GROUP SH.P.K.  
NDËRTIM  
PROJEKTIM  
SHITJE  
INFO: 049-111-101,  
044-511-177  
[www.princesha-ks.com](http://www.princesha-ks.com)

**Bunjamini**  
FABRIKA E LLAQEVE  
MITROVICË  
044/256-051  
044/367-061  
028/532-617  
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

**Kolegji BIZNESI**  
[www.kolegijbiznesi.com](http://www.kolegijbiznesi.com)  
info@kolegijbiznesi.com  
038 500 878 | 045 500 878  
044 500 878 | 049 500 878

**SIGMA**  
VIENNA INSURANCE GROUP  
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A  
DEGA KOSOVË  
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë  
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302  
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

**DINO**  
Konjuh Lipjan, Magj. Prishtinë Ferizaj-Kosovë  
tel & fax +381 38 566 666

### OPINION

#### ADEM DEMAÇI, HERO I KOSOVËS DHE NDERI I KOMBIT



F. 10

Përgatiti: Selatin NOVOSELLA

#### MACRON ME KOSOVËN GODITI NË ZEMËR TË SERBISË F. 12



Ismet SYLEJMANI

### AKTUALE

#### KRU 'PRISHTINA': PAGUANI RREGULLISHT FATURAT E UJIT TË PIJSHËM DHE MOS E KEQPËRDORNI F. 8

#### IKD-JA: QEVERIA NË LARGIM NUK KA LEGJITIMITET TA UDHËHEQË PROCESIN E ZGJEDHJES SË NOTERËVE F. 6

### EKONOMI

#### ME KOMPLETIMIN E ZONAVE EKONOMIKE, KOSOVA PO KRIJON KUSHTE PËR INVESTITORËT E HUAJ F. 9

### KULTURË

#### AMANETI I BABAIT F. 14-15

Sabile KEÇMEZI-  
BASHA



### SPORT

#### FERONIKELI KËRKON REZULTAT POZITIV NË SLLOVAKI F. 19

# Boris Johnsoni, kryeministër i Britanisë së Madhe

Pasi fitoi garën për të parin e Partisë Konservatore në Britani, Boris Johnson, politikani që ka premtuar se do ta largojë Britaninë e Madhe nga Bashkimi Evropian me apo pa marrëveshje më 31 tetor, do ta zëvendësojë Theresa Mayn në pozitën e kryeministrit. Kryeministrin e ri të Britanisë e kanë uruar edhe liderët shtetërorë të Kosovës



**PRISHTINË, 23 KORRIK** - Boris Johnson, politikani që ka premtuar se do të largojë Britaninë e Madhe nga Bashkimi Evropian me apo pa marrëveshje më 31 tetor, do të zëvendësojë Theresa Mayn në rolin e kryeministrit, pasi ka fituar garën për të parin e Partisë Konservatore në Britani, të martën. Fitorja e tij rrezikon që ta bllokojë procesin e Brexit-it, pasi ligjvënësit britanikë janë zotuar se do ta rrëzojnë secilën qeveri që tenton ta largojë Britaninë nga blloku evropian pa një marrëveshje.

Johnson, i konsideruar si fytyra e referendumit të vitit 2016 për Brexit, ka fituar votat e 92 153 anëtarëve të Partisë Konservatore, në krahasim me 46 656 sa ka fituar rivali i tij, sekretari i Jashtëm britanik Jeremy Hunt.

May do të largohet nga zyra kryeministore sot (e mërkurë), pasi ta takojë Mbretëreshën Elizabetë në Pallatin Buckingham.

Kryeministri i ri britanik ka përshëndetur rivalin Jeremy Hunt duke thënë se ai ka "ide të mrekullueshme" të cilat ka premtuar se do t'i huazojë. Për të, kjo fitore përbën "nder të jashtëzakonshëm". Ai, po ashtu, ka falënderuar edhe kryeministren në shkuarje për shërbimin e saj ndaj shtetit. Sipas tij, ka qenë privilegj që ka shërbyer në kabinetin e May, sepse ka parë pasion dhe vendosmëri gjatë udhëheqjes së saj.

Theresa May ka njoftuar se më

7 qershor se do të largohet nga pozita e lideres së Partisë Konservatore në Britani, duke i hapur rrugën procesit të zgjedhjes së kryeministrit të ri.

May është përballur me presion të madh nga partia e saj për t'u larguar nga pozita që ka, pasi plani i saj për largim të Britanisë nga Bashkimi Evropian ka dështuar të miratohet në Parlamentin britanik. Pak minuta pas fitores së Johnsonit, lideri opozitar në Britani, Jeremy Corbyn, ka thënë përmes një postimi në rrjetin social, "Twitter", se Johnsoni nuk e ka fituar mbështetjen nga shteti. "Boris Johnson ka fituar mbështetjen e më pak se 100 000 anëtarëve jopërfaqësues të Partisë Konservatore, duke premtuar ulje të taksave për të pasurit, duke e prezantuar veten si mik të bankierëve dhe duke shtyrë përpara procesin dëmtues të Brexit-it pa marrëveshje. Por ai nuk ka fituar mbështetjen e shtetit", është shprehur ai.

Zgjedhjen e Boris Johnson për kryeministër të ri të Britanisë së Madhe e kanë uruar edhe liderët shtetërorë të Kosovës.

Presidenti i vendit, Hashim Thaçi, ka uruar Boris Johnson me rastin e zgjedhjes kryeministër i ri i Britanisë së Madhe. "Boris Johnson është zgjedhur sot lider i ri i Partisë Konservatore dhe kryeministër i ardhshëm i Britanisë së Madhe. Në emër të popullit të Kosovës uroj mikun tim Johnson, popullin britanik dhe mirëpres vazhdimin e thellimit

të bashkëpunimit ndërmjet dy vendeve tona. Britania e Madhe është partner strategjik, derisa miqësia jonë është e përhershme", ka shkruar Thaçi në llogarinë e vet në "Facebook".

Edhe kryetari i Kuvendit të Kosovës dhe lideri i PDK-së, Kadri Veseli, ka uruar Boris Johnsonin për zgjedhjen kryeministër i Britanisë së Madhe dhe kryetar të Partisë Konservatore.

Veseli ka thënë se zgjedhja e Johnsonit në krye të ekzekutivit britanik do t'i përmirësojë edhe më tej marrëdhëniet e Kosovës me Britaninë e Madhe. "Uroj Boris Johnson për zgjed-

hjen si kryetar i Partisë Konservatore dhe kryeministër i Britanisë së Madhe. Gjatë kohës që ishte në drejtim të Ministrisë së Jashtme britanike ai ka treguar vëmendje të madhe ndaj Kosovës dhe Ballkanit. Zgjedhja e tij në krye të ekzekutivit do t'i përmirësojë edhe më tej marrëdhëniet e vendin tonë me këtë shtet mik. PDK-ja është gjithashtu aleate e Partisë Konservatore dhe ne jemi të bindur që nën udhëheqjen e tij kjo parti do të arrijë suksese të mëtëjshme, ndërsa bashkëpunimi ynë ndërpartiak do të forcohet edhe më shumë", ka shkruar Veseli në llogarinë e vet në "Facebook".

Edhe kryeministri në dorëheqje i Kosovës, Ramush Haradinaj, ka uruar kryeministrin e sapozgjedhur të Britanisë së Madhe, Boris Johnson. Haradinaj ka theksuar se marrëdhëniet në mes të dy shteteve do të vazhdojnë të forcohen edhe më tutje. "Urime për udhëheqësin e sapozgjedhur të Britanisë së Madhe, Boris Johnson! Marrëdhënia dypalëshe e vjetër e Kosovës me Britaninë e Madhe do të vazhdojë të lulëzojë dhe të forcohet, pasi Kosova të afrohet më pranë strukturave euroatlantike", ka shkruar Haradinaj në llogarinë e vet në "Twitter".

## Rama shkarkon Bushatin nga drejtimi i PS-së në Shkodër

**TIRANË, 23 KORRIK** - Ditmir Bushati është një nga ministrat më jetëgjatë të Partisë Socialiste që është shkarkuar dhe tashmë nuk ka asnjë post. Ka qenë vetë kryeministri Rama, që në mbledhjen e Asamblesë e deklaroi largimin e Bushatit si koordinator në Shkodër dhe zëvendësimin e tij me kryebashkiakun e sapozgjed-

hur Valdrin Pjetri.

Arsyet e lënies së Ditmir Bushatit pa asnjë post nuk kanë lidhje të drejtpërdrejtë me ndryshime emrash, por me qejfmbetje mes të dyve. Ditmir Bushati është një prej emrave, që Rama nuk e përfshiu as në fushatë direkte në qarkun e Shkodrës, me përjashtim të vetëm dy takimeve.

Vetë Bushati duke qenë kritik me Partinë Socialiste dhe informacioneve të mbërritura te Rama, për një afrim të mundshëm me Metën, gjatë kohës që ky i fundit kishte në dorë dekretimin e Gent Cakajt si ministër i Jashtëm, kanë qenë pak a shumë arsyet e një largimi në heshtje të Bushatit nga kryeministri Rama.



# Kompletimi i KQZ-së, çështje urgjente

Njohësit e çështjeve kushtetuese dhe zgjedhore, Mazllum Baraliu dhe Blerim Burjani, kanë vlerësuar se pas zhvillimeve të fundit në skenën politike, kompletimi i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) është urgjent. Ata i kanë bërë thirrje Gjykatës Kushtetuese që me prioritet ta shqyrtojë ankesën e subjekteve politike lidhur me ligjshmërinë e vendimit të presidentit për emërimin e anëtarëve të KQZ-së muaj më parë. Sipas tyre, në bazë të këtij vendimi presidenti duhet t'i emërojë edhe dy anëtarë të rinj të KQZ-së nga radhët e koalicionit PAN

**EPOKA E RE**

Shqipe HETEMI

PRISHTINË, 23 KORRIK - Pas dorëheqjes së kryeministrit Ramush Haradinaj vendi pritët të shkojë në zgjedhje të parakohshme, mirëpo Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) që organizon këto zgjedhje është i pakompletuar meqë në të nuk janë të përfaqësuar tri partitë e koalicionit qeverisës PAN (PDK, AAK dhe Nisma). Bazuar në zhvillimet e fundit në skenën politike, njohësit e çështjeve kushtetuese dhe zgjedhore kanë thënë se kompletimi i KQZ-së është çështje urgjente. Njohësi i çështjeve kushtetuese dhe ish-kryeshefi i Sekretariatit të KQZ-së, Mazllum Baraliu, ka thënë të martën për gazetën "Epoka e re" se KQZ-ja është funksionale, por kompletimi i këtij institucioni duhet të bëhet sa më parë. "KQZ-ja është funksionale, ka kuorum dhe ka filluar të punojë, edhe pse është fatkeqësi që për më shumë se një vit ishte jashtë funksionit, duke mos qenë institucion i kompletuar. Tani KQZ-ja është funksionale dhe ka mundësi që me shumicë votash të marrë vendime dhe të procedojë çështjen për zgjedhjet e parakohshme për të cilat duhet të bëhet plani operacional i KQZ-së dhe punët e tjera. KQZ-ja edhe pa këta dy anëtarë është funksionale, por sigurisht se sa më shpejt duhet të kompletohet dhe fuqizohet. Pas kompletimit vendimet e KQZ-së do të ishin të vlefshme dhe të pakontestuar dhe nuk do të lënin mundësi që eventualisht në rastet kur PAN-i nuk do të ishte i kënaqur me vendimet e KQZ-së ta adresojë pastaj pakënaqësinë e mungesës së përfaqësuesve të

tij në këtë institucion", është shprehur Baraliu.

Ai i ka bërë thirrje Gjykatës Kushtetuese që me prioritet ta shqyrtojë ankesën e subjekteve politike lidhur me ligjshmërinë e vendimit të presidentit për emërimin e anëtarëve të KQZ-së muaj më parë. "Situata është emergjente sepse momenti politik është i papritur dhe çështja e atyre dy anëtarëve potencialë është dërguar në Gjykatën Kushtetuese e cila është nuk është deklaruar rreth kësaj çështje deri më tani. Por, mendoj se detyra e parë që duhet të bëjnë institucionet tona është që Gjykata Kushtetuese duhet ta marrë me prioritet ankesën e dërguar nga subjektet politike lidhur me

vendin e presidentit për emërimin e anëtarëve të KQZ-së. Këto ditë gjykata duhet të flasë se cili është qëndrimi i saj për këtë çështje. Dhe në bazë të vendimit të Gjykatës Kushtetuese presidenti do të veprojë tutje për emërimin e dy anëtarëve të rinj të KQZ-së për ta kompletuar këtë institucion", ka deklaruar ai, duke shtuar se vendimi i gjykatës nuk do të lë hapësirë për zvarritje të mëtutjeshme. "Asnjë prej subjekteve politike nuk ka të drejtë dhe as mundësi që të mos i zbatojë vendimet e Gjykatës Kushtetuese dhe ai vendim do të sqarohet për të gjitha subjektet pretenduese edhe brenda koalicionit PAN se kush ka të drejtë dhe kush jo ta dërgojë përfaqësuesin e vet në KQZ. Formula në Kushtetutë është e zgjidhur, por atë po e kontestojnë disa subjekte, kështu që me vendimin e gjykatës do të sqarohet çdo gjë", ka theksuar Baraliu.

Edhe ish-anëtari i KQZ-së, Blerim Burjani, ka thënë për gazetën "Epoka e re" se sa më parë presidenti duhet t'i emërojë dy anëtarë të rinj të KQZ-së. Ai ka vlerësuar se një KQZ e kompletuar është shumë e nevojshme dhe e domosdoshme para se vendi të shkojë

në zgjedhje të parakohshme. "KQZ-ja duhet të kompletohet me dy anëtarë të rinj sepse të gjitha partitë parlamentare duhet t'i kenë përfaqësuesit e vet në këtë institucion. Një KQZ e kompletuar është shumë e nevojshme dhe e domosdoshme para se vendi të shkojë në zgjedhje të jashtëzakonshme nëse partitë vendosin për një gjë të tillë pa e provuar procedurën e rizgjedhjes së një kryeministri të ri brenda afatit kushtetues 60 ditorë. Pra, duhet ende kohë për ta qartësuar temën e zgjedhjeve të jashtëzakonshme sepse me automatizëm nuk ka zgjedhje të jashtëzakonshme, por duhet të respektohen procedurat kushtetuese", është shprehur Burjani, duke shtuar se ashtu siç e parasheh Kushtetuta e Republikës së Kosovës, presidenti duhet ta kompletojë KQZ-në. Megjithatë, ai ka rikujtuar se për të ndodhur një gjë e tillë është i domosdoshëm vendimi i Gjykatës Kushtetuese. "Mirëpo për këtë temë është një proces në Gjykatën Kushtetuese ku është ankuar Nisma dhe PSD-ja, prandaj duhet prititur Gjykata Kushtetuese e cila është vonuar deri më tash. Mirëpo nuk ka nevojë të pritët më tutje, sepse është nevojë urgjente që

Kushtetuesja të nxjerrë një vendim për këtë çështje ose ta hedhë poshtë. Edhe pse unë mendoj se Kushtetuesja nuk do të merret më me KQZ-në", ka deklaruar ai. Sipas Burjanit, nuk mund të mbahen zgjedhjet e reja pa përfaqësuesit e partive parlamentare në KQZ. "Ndonëse PAN-it i kanë takuar tre anëtarë në KQZ, një gjë e tillë nuk ka ndodhur dhe kjo është shkelje kushtetuese. Sidoqoftë, presidenti u ngutë në këtë temë dhe lënda sërish shkoi në gjykatë. Nuk është e udhës që KQZ-ja të mbetet e pakompletuar. Nuk mund të mbahen zgjedhje pa përfaqësuesit e partive parlamentare në KQZ. Është fakt se nuk mund të ketë zgjedhje kredibile, të besueshme dhe të pranueshme për këto subjekte nëse nuk i kanë përfaqësuesit e vet në KQZ", ka theksuar Burjani, duke shtuar se aktualisht është një amulli dhe nuk dihet nëse do të provohet që gjysma e mandatit të PAN-it të ripërtërihet me një kryeministri të ri brenda afatit të paraparë. "AAK-ja po mendon se mund ta çojë vendin në zgjedhje, mirëpo shteti nuk çohet në zgjedhje pse iu ka tekur një njeriu, por përmes mekanizmave kushtetues", është shprehur Burjani.



## Kuvendi i Kosovës hap dyert për bashkatdhetarët

PRISHTINË, 23 KORRIK (ER) - Sot dhe nesër Kuvendi i Republikës së Kosovës organizon aktivitetin tradicional "Bashkatdhetarët në Kuvend"

dhe hap dyert për të gjithë bashkatdhetarët. "Të gjithë bashkatdhetarët të cilët dëshirojnë ta vizitojnë Kuvendin e Kosovës dhe të takohen me

deputetë janë të mirëpritur dhe ftohen t'i bashkëngjiten këtij aktiviteti", është thënë në njoftimin e Kuvendit të Kosovës.



Flet për "Epokën e re", Xhavit Haliti

# Dorëheqja e Haradinajt në

## - Partia Demokratike e Kosovës (PDK) do të dalë partia e parë në këto zgjedhje



Nënkryetari i Kuvendit të Kosovës dhe anëtari i Kryesisë së Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Xhavit Haliti, ka thënë se Ramush Haradinaj nuk ka pasur nevojë të japë dorëheqje nga pozita e kryeministrit për një ftesë nga Gjykata Speciale. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", ai ka deklaruar se Haradinaj është dashur të shkojë në Hagë dhe të kthehet për ta vazhduar punën. Deputeti i PDK-së është shprehur i bindur se kjo parti do të dalë fituese në zgjedhjet e parakohshme. Sipas tij, pavarësisht nëse PDK-ja do të shkojë në koalicion parazgjedhor apo jo, kandidat për kryeministër do të jetë Kadri Veseli

**EPOKA E RE** **Muhamet KOCI**

PRISHTINË, 23 KORRIK - Nënkryetari i Kuvendit të Kosovës, Xhavit Haliti, e ka parë të ngutshëm veprimin e kryeministrit Ramush Haradinaj për të dhënë dorëheqje. Ai ka bërë me dije se dorëheqja nga posti i të parit të qeverisë për një ftesë nga Gjykata Speciale ka qenë e panevojshme. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", deputeti i PDK-së ka thënë se Haradinaj ka mundur të shkojë në Hagë dhe të kthehet për ta vazhduar punën. "Mendoj se ai

ka mundur të shkojë në Hagë të deklarohet për atë që e kanë ftuar dhe të kthehet prapë në detyrë. Sa kam dëgjuar, nuk ka pasur ftesë për t'u arrestuar, sepse nuk ka pasur aktakuzë. Mendoj se për këtë arsye nuk ka pasur nevojë që të japë dorëheqje", ka thënë Haliti. Sipas tij, kryeministri dhe ish-pjesëtarët e tjerë të UÇK-së po paraqiten para një gjykate të Kosovës e jo para një gjykate të huaj siç po deklarohen. "Së dyti, ai nuk ka shkuar në një gjykatë të huaj, por në një gjykatë të Kosovës. Mendoj se po bën lapsus ai kur po thotë se po shkon në një

gjykatë të huaj dhe nuk po do ta çojë kryeministrin e Kosovës në një gjykatë të huaj. Ajo është një gjykatë e Kosovës, pra është Gjykatë e Dhomave të Veçanta dhe vepron e funksionon në bazë të ligjeve dhe Kushtetutës së Kosovës", është shprehur ai. Haliti ka treguar se PDK-ja është e gatshme për zgjedhje të reja, duke shtuar se fillimisht duhet të konsumohet procedura e paraparë kushtetuese. "Nëse ka zgjedhje unë pres që PDK-ja të dalë fuqishëm si partia e parë dhe të jetë protagoniste e krijimit të institucioneve kryesore të shtetit", është shprehur ai.

Megjithatë, nënkryetari i Kuvendit të Kosovës ka thënë se deri më tani asnjëherë zgjedhjet e parakohshme nuk kanë zgjidhur probleme. "Po deklaroj publikisht se ne kemi tri palë zgjedhje të cilat i kemi bërë pa përfunduar mandatin. Dhe në të gjitha zgjedhjet kemi thënë se zgjedhjet janë zgjidhje e problemit, por realiteti është se asnjë palë zgjedhje të parakohshme nuk e kanë zgjedhur problemin. Përkundrazi, vetëm i kemi dëmtuar në veçanti interesat ekonomike të Kosovës, kemi dëmtuar procesin e ndërtimit të institucioneve demokratike dhe kemi shpenzuar buxhetin e Kosovës", ka deklaruar Haliti.

**"Epoka e re":** Z. Haliti, si e ka parë dorëheqjen kryeministrit Haradinaj? A ka qenë veprim i duhur?

**Haliti:** Duke pasur parasysh veprimet që i ka bërë edhe herën e parë kur ka shkuar në Hagë, kësaj radhe ndoshta vendimin e ka marrë vetë, sepse ne nuk kemi ditur se do të japë dorëhe-

qje. Në këtë mënyrë na ka gjetur edhe të papërgatitur politikisht dhe emocionalisht. Mendoj se ai ka mundur të shkojë në Hagë të deklarohet për atë që e kanë ftuar dhe të kthehet prapë në detyrë. Sa kam dëgjuar nuk ka pasur ftesë për t'u arrestuar, sepse nuk ka pasur aktakuzë. Mendoj se për këtë arsye nuk ka pasur nevojë që të japë dorëheqje. Së dyti, ai nuk ka shkuar në një gjykatë të huaj por në një gjykatë të Kosovës. Mendoj se po bën lapsus kur po thotë se po shkon në një gjykatë të huaj dhe nuk po do ta çojë kryeministrin e Kosovës në një gjykatë të huaj. Ajo është një gjykatë e Kosovës, është Gjykatë e Dhomave të Veçanta dhe vepron e funksionon në bazë të ligjeve dhe Kushtetutës së Kosovës.

**"Epoka e re":** Pas këtij veprimi të kryeministrit të gjitha partitë, të pozitës dhe opozitës, kanë shprehur gatishmërinë për të shkuar në zgjedhje. Do të duhej të shkohet në zgjedhje apo të provohet ashtu siç e parasheh

# Uk ka qenë e nevojshme

nistër dhe të vazhdojë respektimin e marrëveshjes ekzistues, besoj se ky koalicion ka kapacitete dhe mundësi ta vazhdojë punën edhe më tutje.

**"Epoka e re":** Si mendoni se do të dalë në këto zgjedhje PDK-ja, meqenëse tashmë kjo parti ka përfunduar edhe procesin e brendshëm zgjedhor?

**Haliti:** Nëse ka zgjedhje, unë pres që PDK-ja të dalë fuqishëm partia e parë dhe të jetë protagoniste e krijimit të institucioneve kryesore të shtetit.

**"Epoka e re":** Do të bëjë ndonjë koalicion parazgjedhor apo do të shkon vetëm në zgjedhje?

**Haliti:** Do të varet shumë nga konfiguracioni politik i këtyre partive politike. Ne kemi një joshje do të thosha në mes të partive të majta dhe të djathta, sepse të gjithë përcaktohem në një farë mënyrë se çfarë orientimi politik kanë partitë, por kur është fjala për zgjedhje, harrojnë se a janë të majtë apo të djathtë. Mendoj se PDK-ja do të dalë e para në këto zgjedhje, ndërsa koalicionet varen shumë nga vullneti dhe interesat e partive politike. Në politikë gjithçka mund të ndryshojë. Me rëndësi është të shohim se cili është varianti: vazhdimi i qeverisjes me një kryeministër tjetër apo krijimi i institucioneve të reja. Po deklaroj publikisht se ne kemi tri palë zgjedhje të cilat i kemi bërë pa përfunduar mandatin. Dhe në të gjitha zgjedhjet kemi thënë se zgjedhjet janë zgjidhje e problemit, por realiteti është se asnjë palë zgjedhje të parakohshme nuk e kanë zgjedhur problemin. Përkundrazi, vetëm i kemi dëmtuar në veçanti interesat ekonomike të Kosovës, kemi dëmtuar procesin e ndërtimit të institucioneve demokratike dhe kemi shpenzuar buxhetin e Kosovës. Sidoqoftë, ne jemi të gatshëm të marrim pjesë në zgjedhje dhe t'i fitojmë ato.

**"Epoka e re":** I bie kjo se më mirë do të ishte të vazhdohet puna e kësaj legjislature sesa të shkohet në zgjedhje të reja?

**Haliti:** Jo, unë thashë se ekziston mundësia kushtetuese për ta provuar. Se a është më mirë apo jo do ta vlerësojnë të gjithë. Vlerësimi im është individual. Mendoj se koalicioni aktual, nëse duhet edhe zgjerimi i koalicionit, Kosova ka kapacitete për mirëqeverisje nëse dëshirojnë ta bëjnë këtë. Kosovës nuk i duhet vetëm kryeministri, sepse unë po i lexoj këto deklaratimet e këtyre partive politike të cilat po thonë

se nëse shkon Ramushi vjen Albini ose dikush tjetër, Kosova do të përparojë. Jo. Kosova nuk mund të përparojë në variantin e emrave individualë. Kosova mund të përparojë vetëm kur institucionet politike dhe ligjzbatuese të Kosovës do të jenë të barabarta para ligjit dhe kur ato ta ndërpresin përfundimisht krimin dhe korrupsionin.

**"Epoka e re":** Nëse vendoset që të shkohet në zgjedhje të reja, sa është i mundshëm që përsëri të shkojë bashkë në zgjedhje koalicioni PAN, por kësaj herë me kandidat për kryeministër z. Veseli?

**Haliti:** Mendoj se PDK-ja ka bërë një veprim të gabueshëm kur ka pranuar që postin e kryeministrit t'ia japë një partie tjetër. Edhe pse partitë politike në çdo situatë luftojnë për ta mbajtur

pushtetin, sepse përmes pushtetit ato mund t'i realizojnë programet e tyre politike. Sidoqoftë, ka qenë vullneti i z. Veseli dhe i partisë në përgjithësi që partitë e dala nga UÇK-ja të jenë bashkë. Së dyti, është menduar se kështu së bashku do të marrim vendime të mëdha në interes të vendit dhe, po ashtu, do të përballemi me sfidat që kanë të bëjnë me zhvillimin e vendit, me luftën kundër krimit të organizuar dhe kundër korrupsionit. Pra, është menduar që me përpjekje të përbashkëta titanike t'ia sigurojnë Kosovës integritimin në institucione ndërkombëtare dhe ta marrin liberalizimin e vizave. Por çfarë duhet të bëjmë tash. Ne si parti politike mendoj se duhet të dalim me kandidaturën tonë për kryeministër. Besoj fuqishëm se në këtë mënyrë ne do të dalim

fitues dhe z. Veseli do të jetë kryetar i qeverisë së ardhshme pas zgjedhjeve. Tani nuk e di se cilat janë raportet individuale në mes të individëve të veçantë të cilët kanë pasur përgjegjësinë kryesore për qëndrimin e këtij koalicioni dhe prishjen eventuale të tij. Se a do të ketë mundësi apo jo për përsëritjen e këtij koalicioni është çështje ditësh që do ta kuptojmë edhe nga zhvillimet që do të rrjedhin. Jam plotësisht dakord që z. Veseli të jetë kandidat për kryeministër të Kosovës, sepse deri më tani, me deklaratime dhe veprime, ka treguar se do të ketë gatishmëri që të përballlet me të gjitha këto që i thashë më lart. Pra, me luftimin e krimit të organizuar, luftimin e korrupsionit dhe përzgjedhjen kualitative të administratës shtetërore në përgjithësi.

## Komuna e Mitrovicës dhe 'Qatar Charity', projekt madhor për familjet skamnore

**MITROVICË, 23 KORRIK (ER)** - Kryetari i Komunës së Mitrovicës, Agim Bahtiri, ka pritur të martën në takim përfaqësuesit e organizatës joqeveritare nga Katar "Qatar Charity", me ç'rast kanë nënshkruar një marrëveshje bashkëfinancimi lidhur me projektin madhor për ndërtimin e lagjes "Frashër" në qytetin e Mitrovicës.

Të pranishëm në këtë takim ishin edhe përfaqësuesit nga organizata "Qatar Charity", ambasadori i shtetit Katar për Shqipëri dhe Kosovë, Ali Bin Hamad Al Marri, drejtori i projekteve nga kjo organizatë, Esam Dabab, drejtori për Gjeodezi, Kadaster dhe Pronë, Egzon Jashari, drejtori për Shërbime Publike dhe Infrastrukturë, Naser Muja, drejtoresha për Integritim Evropian dhe Mirëqenie Sociale, Nazan Kërveshi, si dhe përfaqësues të tjerë nga kjo organizatë.

Gjatë këtij takimi kryetari Bahtiri së bashku me ambasadorin e shtetit të Katarit, Ali Bin Hamad Al Marri, kanë nënshkruar këtë marrëveshje bashkëfinancimi për zbatimin e projektit për ndërtimin e lagjes "Frashër" me sipërfaqe prej 3.27 ha (3 ha 27 ari 65 m<sup>2</sup>). Ky projekt madhor për qytetin e Mitrovicës parashihet të ketë 40 shtëpi për përfituesit me kushte të dobëta

ekonomike dhe pa vendbanim, një shkollë, një shtëpi të shëndetit, katër lokale afariste, një objekt i destinuar për shfrytëzim nga Organizata "Qatar Charity" dhe një xhami. Ndërsa Komuna e Mitrovicës, në cilësinë e bashkëfinancueses, ka dhënë në shfrytëzim pronën e paluajtshme me qëllim të ndërtimit të shtëpive për arsye humanitare si dhe do ta marrë përsipër rregullimin e tërë infrastrukturës përcjellëse të kësaj lagjeje. Me këtë rast, kryetari i komunës, Agim Bahtiri, ka falënderuar ambasadorin e Katarit dhe përfaqësuesit e këtij shteti për mbështetjen e tyre të vazh-

dueshme ndaj qytetarëve të Mitrovicës, duke thënë se është shumë i kënaqur me bashkëpunimin e deritashëm të organizatës Bamirëse "Qatar Charity", e cila ka mbështetur Mitrovicën me projekte madhore në sektorë të ndryshme, duke kontribuar kështu në zhvillimin dhe përmirësimin e cilësisë së jetës së qytetarëve. Kurse ambasadori i shtetit Katar, Ali Bin Hamad Al Marri, ka theksuar se ndihet tejet i lumtur që ndodhet në qytetin e Mitrovicës dhe që shteti i tyre ka arritur ta ndihmojë Kosovën me projekte të ndryshme, e veçmas duke ndihmuar familjet në nevojë.



*Kushtetuta, që koalicioni aktual ta gjejë një kandidat tjetër për kryeministër?*

**Haliti:** Në çdo situatë mendoj se ne duhet t'i zbatojmë rregullat kushtetuese. Vetëm nëse rregullat kushtetuese nuk e mundësojnë zgjedhjen e problemit mund të bëhet revolucioni. Po e quaj kështu sepse pamundësohet mënyra për t'u rikrijuar institucionet. Kur nuk ka zgjidhje duhet të shkohet në zgjedhje për t'i krijuar institucionet e reja. Sa iu përket zgjedhjeve, ne si parti jemi deklaruar se jemi të gatshëm për zgjedhje. Mirëpo, unë besoj se presidenti ka për detyrim kushtetues që t'i zbatojë strikt rregullat që ia përcakton Kushtetuta.

**"Epoka e re":** A besoni se koalicioni aktual e ka vullnetin dhe fuqinë që ta nxjerrë edhe një kandidat për kryeministër dhe ta vazhdojë punën kjo legjislaturë?

**Haliti:** Nëse koalicioni aktual është i gatshëm për ta zgjedhur një kandidaturë për kryemi-

## Fillon revitalizimi rreth lokacionit historik të varrezave hebraike

PRISHTINË, 23 KORRIK (ER) - Zyra e Bashkimit Evropian (BE), Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (UNDP), Komuna e Prishtinës, si dhe partnerët e projektit, Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Cultural Heritage without Borders dhe përfaqësues të komunitetit, filluan të martën punimet për revitalizimin e varrezave hebraike në Arbëri. Këto varreza datojnë nga shekulli i 19-të kur komuniteti hebraik në Prishtinë numëronte rreth 1 500 anëtarë. Ky lokacion historik

është i përfshirë në listën e vendeve të trashëgimisë kulturore të mbrojtura nga Qeveria e Kosovës.

Punimet që do t'i implementojë projekti do ta përfshijnë rehabilitimin e zonave rreth varrezave si dhe krijimin e një sheshi të vogël për aktivitete fetare në mënyrë që anëtarët e familjeve, pasardhësit dhe të tjerë të interesuar, ta kenë qasjen sa më të lehtë. Vizitorët do ta kenë mundësinë të lexojnë mbi historinë hebraike në Kosovë dhe në mënyrë specifike mbi historinë e këtij

lokacioni në panelet që do të vendosen aty.

Ky lokacion që do të restaurohet është një nga 18 sosh në tërë Kosovën si urat e Terëzive dhe Tabakut në Gjakovë, kisha e Shën Nikollës në Janjevë, kisha ortodokse e Shën Nikolla Tutic në Prizren, që do të rehabilitohen përmes projektit Dialogu Ndërkomunitar Gjithëpërfshirës për Ruajtjen e Trashëgimisë Kulturore të financuar nga Instrumenti i BE-së për Paqe dhe Stabilitet (IcSP/BE) dhe implementuar nga UNDP-ja.



# IKD-ja: Qeveria në largim nuk ka legjitimitet ta udhëheqë procesin e zgjedhjes së noterëve

**EPOKA E RE** Qendresa RAMA

PRISHTINË, 23 KORRIK - Instituti i Kosovës për Drejtësi (IKD) ka reaguar ndaj shpalljes së konkursit publik për zgjedhjen e noterëve të shpallur sot nga Ministria e Drejtësisë (MD). IKD-ja në këtë reagim ka theksuar se e kupton rëndësinë e përmbylljes së procesit të përzgjedhjes dhe emërimit të noterëve të rinj në tërë territorin e Republikës së Kosovës, drejt përmirësimit të qasjes në drejtësi për qytetarët e Kosovës. "Sidoqoftë, duke marrë për bazë faktin se nga data 19 korrik qeveria aktuale është në largim pas dorëheqjes së kryeministrit Haradinaj. Parimet bazë të sundimit të ligjit dhe qeverisjes së mirë kërkojnë që qeveritë në largim, përfshirë ministritë e linjës, nuk kanë legjitimitet të marrin vendime për udhëheqjen e proceseve të rëndësishme sikurse është rasti konkret me procesin e përzgjedhjes së noterëve të rinj", është thënë në reagimin e IKD-së. Sipas IKD-së, kur kësaj i shtohet fakti se rreth provimit të noterisë është zhvilluar një debat i gjerë publik me akuza të ndërsjella



rreth mënyrës së udhëheqjes së këtij procesi dhe përzgjedhjes së kandidatëve të suksesshëm, IKD vlerëson se, si i tillë, ky proces është i kompromituar në publik. "Kompromitimi në publik i procesit të noterëve dhe mungesa e legjitimitetit të qeverisë në largim për të marrë vendime në

interes të përgjithshëm, e zbehin besimin e publikut në këtë proces të zgjedhjes së noterëve të rinj. IKD fton Ministrinë e Drejtësisë të reflektoj mbi situatën e krijuar dhe ta rishikoj vendimin për shpalljen e këtij konkursi, i cili është i domosdoshëm por jo në këtë fazë kur

Kosova udhëhiqet nga qeveria në largim", është theksuar në këtë reagim.

IKD-ja ka vlerësuar se ky parim duhet të vlejë edhe për vetë Zyrën e Kryeministrit dhe ministritë e tjera të linjës, të cilat gjatë kohës kur Kosova udhëhiqet nga qeveria në

largim, nuk duhet të marrin vendime për të cilat nuk kanë legjitimitet, por të bazohen vetëm në ushtrimin e detyrave dhe përgjegjësi të domosdoshme për ta mbajtur funksionale administratën shtetërore, që hyjnë në kuadër të fushëveprimtarive të tyre.

## Matoshi dhe Haziri nënshkruan marrëveshjen për krijimin e zonave të gjelbra në Gjilan

PRISHTINË, 23 KORRIK (ER) - Ministri i Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, Fatmir Matoshi dhe kryetari i Komunës së Gjilanit, Lutfi Haziri, të martën kanë nënshkruar një memorandum bashkëpunimi për financimin e projektit "Krijimi i zonave të gjelbra në Gjilan", në vlerë prej 550 mijë eurosh. Ministri Matoshi ka thënë se Komuna e Gjilanit ka trashëguar shumë probleme në

fushën e mjedisit andaj, sipas tij, përmes investimeve kapitale kjo komunë do të arrijë një zhvillim të qëndrueshëm.

I pari i MMPH-së ka treguar që këtë vit në Gjilan po fillojnë së realizuari pesë projekte që në total kapin vlerën prej 1 milion e gjysmë eurosh. Ministri Matoshi ka kërkuar edhe nga Qeveria e Kosovës që ta ndihmojë Komunën e Gjilanit ta tejkalojë krizën aktuale të mungesë së ujit të

pijshtëm.

Gjatë konferencës për media, ministri Matoshi ka përmendur edhe projektin më të madh për ndërtimin e impiantit për trajtimin e ujërave të zeza në Gjilan, të cilin e ka vlerësuar të domosdoshëm për këtë komunë. Ndërsa kryetari i Komunës së Gjilanit, Lutfi Haziri, ka thënë se projekti "Krijimi i zonave të gjelbra në Gjilan" është i domosdoshëm për qytetarët e kësaj komune.



Përfaqësuesit e Lëvizjes Vetëvendosje kanë mbajtur konferencë për medie në lidhje me zhvillimet e fundit në vend

# Vetëvendosja kërkon zgjedhje të menjëhershme

Zyrtarë të lartë të Lëvizjes Vetëvendosje kanë thënë të martën se qeveria në dorëheqje është duke vazhduar marrjen e vendimeve të dëmshme për Kosovën. Sipas tyre, roli i kësaj qeverie duhet të jetë vetëm transitor. Shefi i grupit parlamentar i kësaj lëvizjeje, Glauk Konjufca, ka thënë se e vetmja ftesë e pranueshme nga presidenti Hashim Thaçi është ajo për caktimin e mbajtjes së zgjedhjeve të parakohshme parlamentare. Në këtë kontekst, ai ka thënë se Vetëvendosja preferon opsionin e një qeverie të përbashkët me LDK-në



EPOKA E RE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 23 KORRIK - Nënkrjetari i Lëvizjes Vetëvendosje, Besnik Bislimi, dhe kryetari i grupit parlamentar, Glauk Konjufca, kanë shprehur shqetësimin e kësaj lëvizjeje për vendimet të cilat është duke i marrë qeveria në dorëheqje. Konjufca ka thënë se vendimet e qeverisë në dorëheqje janë të dëmshme për vendin. "Vendimet nuk po ndalen edhe kur kjo qeveri është në dorëheqje e, ndoshta, është qeveria e vetme në botë që edhe pas dorëheqjes po i rritet numri i zëvendësministrave. Ndoshta ky do të jetë edhe akti i fundit komik i kësaj qeverie e cila thotë se është duke shkuar, por në të njëjtën kohë zëvendësministri nga 80 bëhen 82", ka thënë Konjufca në një konferencë për medie.

Konjufca ka thënë se Vetëvendosja preferon opsionin e një qeverie të përbashkët me Lidhjen Demokratike të Kosovës (LDK). Në këtë kontekst, ai ka thënë se e vetmja ftesë e pranueshme nga presidenti Hashim Thaçi në këtë moment është ajo për caktimin e datës së zgjedhjeve të reja.

"Qytetarët presin ndryshim. Nuk do të pranohen makinacionet presidenciale që do të synojnë shmangien e zgjedhjeve", është shprehur Konjufca. Ndërsa nënkryetari i Lëvizjes Vetëvendosje, Besnik Bislimi, në këtë konferencë për medie ka vënë në dukje se roli i qeverisë së dorëhequr duhet të jetë vetëm transitor. "Pra, ta mirëmbajë funksionimin normal të administratës publike dhe kryerjen e pagesave rutinore në pajtim me buxhetin e aprovuar të vendit. Rrjedhimisht kompetencat e qeverisë transitore janë tejet të limituara", është shprehur Bislimi.

Ai ka thënë se qeveria aktuale nuk ka më mandat për të implementuar program qeverisës dhe nuk mund të marrë asnjë vendim që ndikon negativisht aftësinë e qeverisë në ardhje për ta implementuar programin e saj qeverisës. "Kjo qeveri nuk guxon të paraqitet në emër të Kosovës lidhur me ndonjë marrëveshje sa i takon Serbisë apo çështje që ndërlidhen me marrëveshje të mëhershme me të", ka thënë Bislimi. Ai ka theksuar se qeveria në dorëheqje nuk mund të merret me përgatitjen e projektbuxhetit për vitin e

ardhshëm. "Nuk mund ta implementojë asnjë projekt madhor infrastrukturor, ta vazhdojë asnjë kontratë me peshë financiare e me ndikim ekonomik dhe të iniciojë asnjë reformë institucionale apo ekonomike. Nuk mund të emërojë asnjë zyrtar në pozita të larta në hierarkinë politike institucionale apo në ndërmarrjet publike dhe shtetërore, agjencitë e pavarura dhe stafin diplomatik të vendit", është shprehur Bislimi.

Më tutje, Bislimi ka thënë se qeveria në dorëheqje nuk guxon të ndërmarrë asnjë hap pasi, sipas tij, çdo aventurë e saj

do të anulohet nga qeveria e ardhshme që në ditën e parë të punës. Ai ka thënë se kjo qeveri duhet ta ndërpresë çdo aktivitet që ndërlidhet me termocentralin e ri në Kosovë apo me shkatërrimin e lumenjve të vendit përmes lejitimit të operimit jashtëligjor të hidrocentraleve. Po ashtu, Bislimi ka thënë se qeveria në dorëheqje duhet të ndërpresë çdo nismë që lidhet me operatorë privatë apo marrëveshje të ngjashme sa i përket ndërmarrjes publike "Trepça". Gjithashtu, ai ka shtuar se qeveria aktuale duhet të ndërpresë çdo aktivitet që ndërlidhet drejtpërdrejt apo indirekt me

privatizimin e Telekomit të Kosovës, si dhe ta ndalojë futjen e Telekomit në borxhe me synim të transferimit të milionave drejt marrëveshjeve haptazi të korruptuara me "Z-Mobile". Nënkrjetari i Vetëvendosjes ka pohuar se qeveria në dorëheqje duhet t'i ndërpresë aktivitetet që ndërlidhen me autostradën e planifikuar të Dukagjinit, synimet për vazhdimin e monopolit në fushën e homologimit dhe ndërprerjen e çdo aktiviteti nga Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë që ndërlidhet me procesin e kompromentuar të botimit të teksteve shkollore.

## Thaçi: UNDP-ja në dy dekadat e fundit ka mbështetur Kosovën në shumë fusha

PRISHTINË, 23 KORRIK (ER) - Presidenti i Republikës së Kosovës, Hashim Thaçi, ka pritur të martën në takim njoftues përfaqësuesen e Programit për Zhvillim të Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNDP), Maria Suokko, duke i uruar mirëseardhje dhe suksese në punë.

Presidenti Thaçi ka theksuar se UNDP në dy dekadat e fundit ka mbështetur Kosovën në shumë fusha. "Jemi të kënaqur me kon-

tributin tuaj në fushën e sundimit të ligjit, mbrojtjes së ambientit, por edhe përkrahjes për zhvillimin ekonomik", u shpreh presidenti Thaçi.

Ndërsa përfaqësuesja e UNDP-së në Kosovë, Maria Suokko, ka thënë se UNDP-ja do të vazhdojë ta përkrahë Kosovën në rrugën e zhvillimit të saj.

Presidenti Thaçi u shpreh se institucionet e Kosovës do të vazhdojnë të bashkëpunojnë dhe t'i përkrahin projektet e UNDP-së.



## Sot lëshohet në funksion rruga ndihmëse në hyrje të Prishtinës nga ana e Veternikut

PRISHTINË, 23 KORRIK (ER) - Ministria e Infrastrukturës dhe Transportit ka njoftuar të gjithë pjesëmarrësit në trafikun rrugor se nga sot (e mërkurë), prej orës 12:00,

lëshohet në funksion rruga ndihmëse (Rrethrotullimi ndihmës për qarkullim normal të trafikut), që do të përdoret deri në përfundimin e punimeve në zgjerimin e

rrugës nacionale N2, segmenti hyrja në qytetin e Prishtinës nga ana e Veternikut, bashkë me urën që i lidhë rrugët nacionale N2 dhe N25.2, me kyçjen e

autostradës R7 "Ibrahim Rugova". MIT-ja ka kërkuar mirëkuptimin e pjesëmarrësve që shfrytëzojnë për qarkullim këtë segment rrugor.



## KRU 'Prishtina': Paguani rregullisht faturat e ujit të pijshëm dhe mos e keqpërdorni

PRISHTINË, 23 KORRIK (ER) - Bordi i Drejtorëve i Kompanisë Rajonale të Ujësllësit "Prishtina" sh.a., në përbërje të Betim Berisha, kryesues, dhe Bajram Jashari, anëtar, së bashku me kryeshefin ekzekutiv të kompanisë Ilir Abdullahu, zëvendëskryeshefin Kujtim Xhelili dhe zyrtarin kryesor financiar Sokol Duraku, kanë vizituar Fabrikën e Trajtimit të Ujit në Shkabaj.

Drejtorët e bordit të ujësllësit të Prishtinës u njoftuan nga afër me fabrikën më të re të ujit të pijshëm në Republikën e Kosovës, gjendjen e përgjithshme të infrastrukturës aktuale të rrjetit të ujësllësit, ujërave të zeza, furnizimin e qëndrueshëm me ujë të pijshëm për komunat në të cilat ofrojnë shërbime të ujësllësit dhe kanalizimit, bashkërendimin e investimeve, projektet specifike zhvillimore, sfidat dhe

vështirësitë me të cilat po përballet Ujësllësi Rajonal "Prishtina", që të gjitha në kontekst të zgjerimit të rrjetit dhe përmirësimit të vazhdueshëm të shërbimeve ndaj konsumatorëve të tetë komunave.

Ndër të tjera, ata u zotuan se me të gjitha kapacitetet e tyre profesionale do të jenë mbështetësit kryesorë për realizimin e objektivave të kompanisë që ndërliqhen me përmirësimin e shërbimeve ndaj konsumatorëve, duke filluar nga furnizimi me ujë të pijshëm 24 orë pa ndërprerë dhe cilësia e ujit bazuar në standardet e Organizatës Botërore të Shëndetësisë, kyçja e vendbanimeve të reja në sistem ujësllësi dhe kanalizimi, mënyra të lehta procesuese në pagesat e shërbimeve, intervenime të shpejta në sistemin e rrjetit të ujësllësit, vendosje e infrastrukturës së re të ujësllësit etj.



Mesazhi i tyre drejtuar konsumatorëve ishte mjaft i qartë, që ata t'i paguajnë rregullisht faturat e ujësllësit

dhe kanalizimit, ta shpenzojnë racionalisht ujin e pijshëm dhe mos ta shpërdorin. Bordi i Drejtorëve i Kompanisë

Rajonale të Ujësllësit "Prishtina" ka garantuar shërbime më cilësore për konsumatorët.

## Komuna e Mitrovicës premtion mbështetje për të verbrit



MITROVICË, 23 KORRIK (ER) - Koordinator i Njësisë për të Drejtat e Njeriut në Mitrovicë, Fitim Rama, ka realizuar një takim me drejtorin ekzekutiv të Shoqatës së Verbërve të Kosovës, Mexhit Foniqi, me të cilin është biseduar për gjendjen aktuale të Shoqatës së të Verbërve të Kosovës, me theks të posaçëm për përmirësimin e gjendjes së verbërve, duke kërkuar përkujdesje më të madhe të institucioneve lokale dhe qendrore. Po ashtu, gjatë këtij takimi Foniqi ka folur edhe për mbajtjen e

punëtorive me temën "Fuqizimi i të Drejtave Ligjore të Personave të Verbër përmes avokimit në nivel lokal", saktësisht nenit 8 të këtij ligji i cili është në kompetencë të kuvendit komunal. Ndërsa Skender Kerolli, kryetar i Shoqatës së Verbërve të Mitrovicës, ka folur për problemet që ka shoqata e tyre për realizimin e projekteve të ndryshme dhe përpjekjet që po bëhen për ta përmirësuar gjendjen. Ai ka kërkuar nga institucionet dhe shoqëria krijimin e mundësive të barabarta edhe

për personat e verbër. Në anën tjetër, Fitim Rama, koordinator i Njësisë për të Drejtat e Njeriut, ka thënë se në kuadër të mundësive buxhetore që ka komuna, njësi jonë është duke e mbështetur Shoqatën e të Verbërve në Mitrovicë për zhvillimin e aktiviteteve të ndryshme. "Komuna, në bazë të mundësive buxhetore që ka, ka treguar përkujdesje të veçantë për këtë kategori të qytetarëve, në mënyrë që të bëhet integrimi i tyre në shoqëri", ka thënë Rama.

## Rabanica bëhet me asfalt, pritet fillimi i asfaltimit të rrugëve në Dollovë, Dush dhe Jollovc

KLINË, 23 KORRIK (ER) - Kanë filluar të martën punimet për ndërtimin dhe asfaltimin e rrugëve në fshatin Grabanicë, rrugë të tjera të reja të cilat po i shtohen infrastrukturës së përgjithshme rrugore në Komunën e Klinës.

Në fillimin e punimeve i pranishëm ishte edhe kryetari i Klinës, Zenun Elezaj, i cili ka uruar banorët

për këto projekte, duke shtuar se institucionet komunale do të angazhohen vazhdimisht për plotësimin e kërkesave të qytetarëve dhe kompletimin e infrastrukturës rrugore nëpër të gjitha fshatrat.

Ky projekt, i cili ka një vlerë prej 213 mijë eurosh dhe gjatësi rrugore prej 5 kilometrash, është financuar nga

Komuna e Klinës dhe Ministria e Zhvillimit Rural dhe përfshinë edhe asfaltimin e rrugëve në Dollovë, Dush dhe Jollovc, rregullimi i të cilave do të fillojë së realizuari shumë shpejt.

Afati i përfundimit të punimeve, në bazë të kontratës së nënshkruar me operatorin ekonomik, është 100 ditë pune.





Parku i Biznesit në Drenas do të rritet edhe për 30 hektarë

## Me kompletimin e zonave ekonomike, Kosova po krijon kushte për investitorët e huaj



Zëvendësministria e Tregtisë dhe Industrisë, Arbëreshë Krasniqi, ka bërë me dije të martën se Parku i Biznesit në Drenas do të rritet edhe për 30 hektarë, duke krijuar kushte sa më të mira për bizneset vendore dhe të huaja. Ajo ka theksuar se me kompletimin e zonave ekonomike, Kosova po krijon kushte për investitorët e huaj dhe vendorë

**EPOKA E RE** Albulena S. MAVRAJ

**DRENAS, 23 KORRIK** - Zëvendësministria e Tregtisë dhe Industrisë, Arbëreshë Krasniqi, ka thënë se Parku i Biznesit në Drenas do të rritet edhe për 30 hektarë, duke krijuar kushte sa më të mira për bizneset vendore dhe të huaja. Krasniqi ka thënë se duke pasur

parasysh kërkesën e shtuar nga bizneset vendore dhe të huaja, Ministria e Tregtisë dhe Industrisë ka iniciuar zgjerimin e parkut të biznesit.

Krasniqi, në Seminarin e Biznesit Ndërkombëtar për Zhvillimin e Zonës Industriale të Re në Drenas, ka bërë me dije se gjatë këtij mandati Ministria e Tregtisë dhe Industrisë ka vendosur krijimin e kushteve për

t'u ofruar bizneseve infrastrukturë moderne që u mundëson operim më të lehtë dhe hapje të vendeve të reja të punës. "Zonat ekonomike shërbejnë për qasje më të lehtë në autostradë, në ujë, rrymë dhe infrastrukturë përcjellëse. Kemi shpallur nëntë zona dhe parku i Biznesit në Drenas, pjesa e dytë, Ministria e Tregtisë dhe Industrisë, ka filluar projektin për ndërtimin dhe

është një projekt 30 hektarë dhe të gjitha investimet janë nga MTT", ka thënë Krasniqi.

Ajo ka thënë se Ministria e Tregtisë dhe Industrisë, bashkë me Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor dhe Ministrinë e Financave, ka incizuar dhe kompletuar shpronësimin e zonës ekonomike në Drenas. Kjo zonë përfshinë sipërfaqen prej 61 hektarësh dhe më vonë është zvogëluar pasi do të ndërtohet Stadiumi Kombëtar. "Tani kjo zonë pritet të ketë rreth 30 hektarë. Projekti parasheh investime kapitale dhe ndërtimin e qendrës për trajnime profesionale", është shprehur

Krasniqi.

Zëvendësministria Krasniqi ka theksuar se me kompletimin e zonave ekonomike, Kosova po krijon kushte për investitorët e huaj dhe vendorë, që njëkohësisht ua ul koston për shkak të qerasë së vogël që kanë këto zona. "Po ashtu, së shpejti fillon ndërtimi i zonës ekonomike në Malishevë, që është e dedikuar veçanërisht për bizneset e diasporës, që për herë të parë po u ofrohen kushte konkrete, që s'ka ndodhur më herët", ka thënë Krasniqi. Ajo ka bërë me dije se edhe në Skenderaj së shpejti do të fillojë ndërtimi i inkubatorit të bizneseve dhe do të ketë edhe investime të tjera.

## Komisioni për Zhvillim Ekonomik miraton raportin e punës



**PRISHTINË, 23 KORRIK (ER)** - Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti, Industri dhe Zhvillim Rajonal ka miratuar raportin e punës së këtij komisioni për sesionin pranveror 2019. Anëtarët që e votuan këtë raport e cilësuan të suksesshme punën që është bërë gjatë këtij sesioni.

Kryetarja e këtij komisioni, Sala Berisha-Shala, ka prezantuar raportin dhe të arriturat e këtij

komisioni para anëtarëve, duke e vlerësuar punën të suksesshme. "Komisioni ka zhvilluar 52 aktivitete. Punën e Komisionit e kanë monitoruar INDEP, Demokraci + si dhe organizata të tjera. Komisioni ka bërë përzgjedhjen e kandidatëve për bordin e KOST-it, ka përfunduar mbikëqyrjen e zbatimit të dy ligjeve dhe ministrat e dikastereve përkatëse janë ftuar për raportim. Kemi pasur gjashtë raportime të ministrive.

Gjithashtu, gjatë këtij sesioni Komisioni ka realizuar dy vizita jashtë vendit dhe njëmbëdhjetë vizita brenda vendit", ka bërë me dije Berisha-Shala, duke shtuar se pjesëmarrja e anëtarëve të këtij komisioni nuk ka qenë e kënaqshme në vizitat që kanë pasur. "Me gjithë vështirësitë që e kanë përcjell punën e Komisionit, konsideroj se kemi bërë një punë të mirë", ka thënë Sala Berisha-Shala.

## Kryetari i Sindikatës së Telekomit takon përfaqësuesit e kryeprokurorisë

**PRISHTINË, 23 KORRIK (ER)** - Kryetari i Federatës Sindikale të Telekomit të Kosovës (FSP-PTK), Lamih Balaj, është takuar të martën me përfaqësues të Zyrës së Prokurorit të

Shtetit. "Të martën është zhvilluar një takim zyrtar me Zyrën e Kryeprokurorit të Shtetit. FSP-PTK është përfaqësuar nga kryetari z. Lamih Balaj me bashkëpunë-

torin z. Naim Haliti. Takimi ishte shumë përmbajtësor, ku janë diskutuar shqetësimet e ngritura nga FSP-PTK rreth kontratave të dëmshme, me theks të

veçantë kontrata me 'Z-Mobile'. FSP-PTK falënderon Zyrën e Kryeprokurorit të Shtetit për bashkëpunim", është thënë në njoftimin e FSP-PTK.



Me rastin e njëvjetorit të vdekjes së Adem Demaçit (26 korrik 2018)

# ADEM DEMAÇI, HERO I KOSOVËS DHE NDERI I KOMBIT

## - Përshtypjet në "librin e zisë"



**Përgatiti Selatin  
NOVOSELLA**

Po Bacë, ata që donin burgun e shqiptarëve, të burgosën edhe Ty për 28 vjet, por Ti ishe njeri që krijove liri më shumë se çdokush tjetër. Ti ishe e mbete njeriu që krijoi Liri e Bashkim më shumë se çdokush tjetër për shqiptarët. Ti ishe e do të mbetesh vetë Liria. Lavdi jetës dhe veprës Tënde, Baca ynë!

27 korrik 2018,  
Gani Krasniqi

Më 26. VII. 2018, morëm lajmin për vdekjen e z. Adem Demaçi. Ky lajm na i tronditi thellë zemrat, e të gjithë shqiptarëve, anembanë rruzullit tokësor. Ne jemi të gjithë krenar që e patëm një Hero të tillë, i cili na udhëzoi në rrugën e drejtë deri ku jemi sot.

Lavdi mbarë popullit shqiptar!

27 korrik 2018,  
(nënshkrimi i palexueshëm)

O i madhi Baca Adem, o më i çmuari Baca Adem, o më i madhi prej më të mëdhenjve shqiptar, të qoftë i lehtë dhe mbi varrin ku prehesh!

27 korrik 2018,  
Shaqir Zeneli

Lavdi për jetë e mot!  
Atdhetar i përkushtimeve të mëdha, zoti Adem Demaçi!  
- Simbol i rezistencës!  
- Krenaria e kombit shqiptar!  
- Shkrimtari i krijimeve sublime!  
- Ambasador i Paqes në Botë!  
- I nderuar me shumë çmime e mirënjohje në mëmë-dhe dhe në botë!  
- I burgosur 28 vjet për Kosovën e shqiptarinë!  
- Mik dhe i bashkëburgosur politik me babin tim, Destan Bajraktarin, i cili të vlerësoi e të çmoi shumë, ashtu si edhe Ju-Atë!  
- I lehtë të qoftë dhe i Kosovës, shumë i çmuari Adem Demaçi!

27 korrik 2018,  
Naxhie Doçi shkrimtare, Prishtinë

Bacë, Shkove ashtu siç ishe - i thjeshtë, i madh, i thellë, vizionar, kritik, dhe patriot i paepur, për t'iu bashkuar legjendave, duke lënë gjurmë në mendjen dhe zemrat tona. Të qoftë dhe i lehtë Bacë!

27 korrik 2018,  
Me ndjenjat e mia më të thella, A. Shala

Lum si ti Bacë, gjithçka i dhe kësaj toke e këtij kombi dhe asgjë nuk

kërkove nga ta. I nderuar që jetova në Epokën tënde, që do të njihet si Epoka Demaçiane.

27 korrik 2018,  
Ibrahim Sh. Makolli, Prishtinë

Për mua ishe udhërrëfyes i së mirës, i atdhedashurisë, rezistencës dhe madhësisë njerëzore. Qysh si i ri kur isha, e mbaj mend, kur e lexoja librin tuaj "Gjarpinjtë e gjakut", duhej të isha vetëm gjatë leximit. O Bacë, kohë e pa kohë ishte! Faleminderit për çdo gjë që ke bërë për ne, o udhërrëfyes i madhësisë sonë! Lavdi jetës dhe veprës Tuaj!

27 korrik 2018,  
Bajram Rukolli

Sot ndjehem thellësisht i pikëlluar për shkuarjen nga jeta të të papërsëritshmit, Bacës Adem! Bacë, ishe dhe do të mbetesh simbol për ne, për brezat e ardhshëm, se si sakrifkohet e luftohet për Atdheun!

Do na mungosh të gjithëve, mua, Majlindës, fëmijëve të mi, Edonës, Berijanit, Ulpionit, të cilët sa herë takoheshin me Ty, iu rritej shpresa dhe besimi se Shqipëria do të bëhet!

Jeta dhe vepra jote do të jetë përjetësisht e ngulitur në memorien e Kombit! Shpirti yt qoftë përherë i ndritur! Lamtumirë, Baca im i shtrenjtë!

27 korrik 2018,  
Ismet Hajrullahu

Rastësisht, një prej veprave të para lexova "Gjarpinjtë e Gjakut" dhe prej atëherë gjithnjë pata një respekt të madh për Juve, baca Adem. Një pjesë të rrugës jetësore e bëmë bashkë në vitet 75-76 dhe me shërbeu për krenari. Ishe dhe do të mbetesh frymëzimi i pushuar për gjeneratat që do të vijnë. Rrugaja jonë vazhdon... I paharruar kujtimi për Ju - Bacë!

27 korrik 2018,  
Dr. Zyhdi Bilalli

Sot, në këtë ditë, e premtë, të datës 27 korrik, bëmë një vizitë Shoqatës së të Burgosurve politik të Kosovës, dhe me dhembje të madhe dëgjua për vdekjen e Bacës, Adem Demaçit.

Mbarë populli i Kosovës, sot, ndihet me zemër të thyer për humbjen e Heroit tonë - Adem Demaçit, por, njëherë ndihemi krenar, që e patëm dhe na mësoi rrugën se si të vuajmë deri te çlirimi prej okupatorit. Lavdi i qoftë veprës së tij!

27 korrik 2018,  
E. Marmullaku, Prishtinë

Me veprimtarinë e tij atdhetare, Adem Demaçi, u bë i papërsëritshëm, i paarritshëm dhe i pavdekshëm.

27 korrik 2018,  
Jashar Alija



Një jetë e tërë në shërbim të popullit dhe kombit, frymëzues i gjeneratave. Baca Adem do të mbetet babai ynë shpirtëror. Mburrimi dhe krenohemi që të patëm udhëheqës në paqe dhe luftë.

27 korrik 2018,  
Ajet Duli

Ju, Adem Demaçi, jeni shembulli më i mirë si ta duam kombin. Jemi krenar që një pjesë të kohës e bashkëjetuam me ty Baca Adem. Ty Bac të deshëm të gjallë. E vështirë qenka shkua pa i mbyllur të gjitha plagët e kombit shqiptar. Le të rroj kujtimi për ty Bacë. Të jemi mirënjohës për vlerat politike që ia keni lenë kombit. Lavdi!

27 korrik 2018,  
Shefik Sadiku

Kur e pyetem për burgun, Adem Demaçi qe përgjigjur se, vet u bë si qiri që digjet për të ndriçuar të tjerët. Ishte jo vetëm dritë, por edhe flakë lirie për brezat. Ndrëtoi rrugën dhe ngrohu zemrat tona edhe kur nuk ishte midis nesh. Adem Demaçi - flakë e dritë e përjetshme që do të ndriçojë rrugën brazave dhe do të ngrohë zemrat atdhetare brez pas brezi... Krenar që të patëm e do të kemi përherë!

27 korrik 2018,  
(nënshkrimi i palexueshëm)

O Bacë i dashur, ne bëmë pak për Ty, në krahasim çka bërë Ti për kombin e atdheun. Do përpiqemi të bëjmë edhe më shumë tani që nuk të kemi fizikisht në mesin tonë. Lavdi të qoftë përherë!

27 korrik 2018,  
Agush Buja

Baca Adem!  
Nuk kam falë se si të shprehem, por ishe dhe do mbetesh gjithmonë simbol i pashterur-në çdo kohë dhe ndaj çdo okupatori. Ishe këmbëngulës dhe i pa luhatur në

aspiratat tuaja për popullin tuaj dhe tonin që me çdo kusht i ke mbrojtur interesat tona kombëtare.

Lavdi për jetë - i lehtë të qoftë dhe i Kosovës, simbol i pavdekshëm!

27 korrik 2018,  
Sylejman Haziraj

Baca Adem të faleminderit për të gjitha që i ke bërë për ne si komb, e po ashtu faleminderit që familjen tonë nuk e harrove në ditët më të vështira për ne! Shpresoj që Universi do të na takoj prapë ashtu siç thoshe Ti i madhi Baca Adem! Lavdi jetës e veprës tënde! Respekt!

27 korrik 2018,  
Nëntor Fetiu

Vdiq i madhi i Kosovës! Vdiq Baca Adem! Vdiq Adem Demaçi!  
Njeriu që u sakrifkua çdo ditë, javë, muaj, vite e dekada për lirinë e Kosovës. Vdiq flamurtari i luftës për liri të Kosovës. Mbetem pa Ty o prijësi jonë i lirisë! Lavdi jetës dhe veprës tënde! Përkulemi para veprës suaj!

27 korrik 2018,  
Teuta Hadri

Bacë! Ke qenë dhe ke mbetur biri i madh e besnik i kësaj toke e i popullit tonë. Ke qenë e ke mbetur udhërrëfyes për brezat që jetuan edhe ata që do vijnë. Do jetosh përkrah popullit tonë gjer në përjetësi!

Lum ne që të patëm e bashkëjetuam! Lum brezat që do të trashëgojnë mësimet tua!

27 korrik 2018,  
Izet Baraliu, Prishtinë

Baca Adem, Ti ndërrova jetë duke na lënë të pikëlluar në zemrat tona. Ti nuk u ndave nga ne, ti vetëm na tregove rrugën që do ta ndjekim të gjithë pas teje. Këtë e ke bërë tërë jetën. Ke qenë simbol i rezistencës kombëtare dhe kujtimi

për ty do të rroj djalë pas djali. Të qoftë i lehtë dhe i Kosovës!...

27 korrik 2018,  
Adem Tafë Shala, Profesor i Fizikës

Bacë, tërë jetën tënde ia kushtove lirisë së shqiptarëve e fqinjëve të tyre dhe mbarë njerëzimit. Ishe vet Prometheu antik! Të faleminderit që më ndrëcove rrugën të mos gaboj! Lamtumirë!

27 korrik 2018,  
Bajrush Xhemaili

Lamtumirë Bacë!  
Mendja dhe shpirti i kombit!  
I përjetshëm kujtimi për ju!

27 korrik 2018,  
Ferat Shala

Përkulje dhe përkushtim për jetën, veprën dhe sakrificën e Bacës Adem Demaçi, për lirinë e Kosovës martire!

27 korrik 2018,  
Gjergj Dedaj, Zëvendësministër i Jashtëm

Populli ynë dhe opinionin evropian do iu kujtojë përjetësisht!

27 korrik 2018,  
Reshat Sahitaj

Adem Demaçi ishte figura më e ndritshme e historisë sonë më të re kombëtare. Vepra dhe kontributi i tij prej atdhetari e vizionari të çështjes kombëtare është e jashtëzakonshme dhe e papërsëritshme.

Lavdi jetës dhe veprës së Bacës Adem!

27 korrik 2018,  
Nuhi Bytyçi, gazetar

Sot, po nderojmë me homazhe Heroin e Shqiptarisë, Simbolin e ekzistencës, frymëzimit e idealit kombëtar, Bacën Adem Demaçin. Ndaj, do ta nderojmë dhe kujtojmë për jetë e mot figurën dhe veprën e tij! I qoftë i lehtë dhe i Kosovës të cilën e desh dhe sakrifkoi tërë jetën për të!

27 korrik 2018,  
Talat Pllana, kryetar i Bashkësisë Shqiptare "Faik Konica", Londër

Kombit shqiptar sot iu shkëput një yll - ylli që kurrë nuk do të shuhet. Nderoi jetë kryegjenerali /kryekomandanti legjendar, ideatori, frymëzuesi dhe autori i të gjitha kryengritjeve shqiptare në këtë pjesë të atdheut! Ai si pasuesi më dëgjues i shkollës dhe artit luftarak të Hasan Prishtinës, ishte kryetari moral i gjithë rinisë revolucionare të Kosovës. Falë veprës së tij, shqiptarët e Kosovës e përmbyten nazizmin serb.

Lavdi e përjetshme Heroit Kombëtar, Adem Demaçi!

27 korrik 2018,  
Rifat Blaku  
/Vazhdon në numrin e ardhshëm/

Fizika simetrike, udhëtim drejt universit (8)

# Efektet e fushës antimagnetike (antigravitacionale (-G)) të tokës



**Shkruan: Naim KRASNIQI, fizikan**

Fusha antimagnetike ((-B) ?) që buron nga toka është e vetmja forcë që e parandalon goditjen e tokës nga Hëna, e mbron tokën nga goditjet e trupave të tjerë qiellorë qoftë meteor asteroid, e shkakton efektin e baticës dhe zbatcës, përkatësisht është forca e vetme që e ngre nivelin e deteve dhe oqeaneve, e mbron tokën nga rrezatimet e ndryshme, sidomos nga erërat vdekjeprurëse të diellit, që jep formë vertikale botës bimore pavarësisht prej pozitës se ku ndodhet dhe shumë e shumë efekte të tjera.

## Efkti i fushës antimagnetike në rrotullimin e trupave

Dëshirojmë apo nuk dëshirojmë ta pranojmë, fusha antimagnetike (antigravitacionale) ((-B) ?) është e vetmja forcë që ndikon në rrotullimin e trupave qiellorë. Po të mos ekzistonte kjo fushë antimagnetike, Hëna as që do të ekzistonte, me miliardë vite më parë do të ishte përplasur me tokën.

Hëna nuk ka fushë magnetike të fortë por vetëm një magnetizim të padukshëm nga toka, prandaj nuk mund të ketë fushë antimagnetike, ky është argumenti që rreth Hënës nuk rrotullohen trupa të tjerë qiellorë, por as nuk mbrohet nga goditja e trupave qiellorë, prandaj është e rrezikshme, sepse kohë pas kohe bien trupa mbi sipërfaqen e Hënës. Gjasat për të qëndruar në Hënë janë absolutisht të pamundshme për shkak të mungesës së kësaj force. Shkuarja në sipërfaqen e Hënës është sikur loja e roletës ruse, që në çdo kohë mund të mos ekzistosh. Mjafton

të shikohet sipërfaqja e Hënës nga goditjet, nuk do fare komente.

Venera dhe Merkuri janë trupa që nuk kanë fusha magnetike as fusha antimagnetike, prandaj nuk ka asnjë trup që rrotullohet rreth tyre, nga fakti se nuk posedojnë fushë antimagnetike, përkatësisht nuk posedojnë fushë mbrojtëse.

## Ndikimi i fushës antimagnetike në rrotullimin e Hënës rreth tokës

Ashtu sikur toka që rrotullohet rreth boshtit të vet, me shpejtësi këndore ?1, njëjtë edhe Hëna kohë më parë është rrotulluar rreth boshtit të vet, por me një shpejtësi më të vogël ?2. Në një kohë jo të largët është përplasur mbi sipërfaqen e Hënës një trup i cili kishte në përbërjen e tij materiale ferromagnetike.

Në këtë trup qiellor ferromagnetik që e kishte goditur Hënë, vepron forca e fushës antimagnetike e tokës ((-B) ?), e cila nuk e lejon trupin ferromagnetik në sipërfaqen e Hënës të bëjë rrotullime rreth qendrës, ashtu siç bën rrotullime toka rreth boshtit të vet në raport me diellin.

Për ta kuptuar më thjeshtë, Hëna rrotullohet rreth boshtit të vet në kahje të kundër me akrepat e orës, kështu pas çdo rrotullimi ne gjithmonë e shohim më parë pikën (b) pastaj pikën (a), dhe asnjëherë nuk ndodhë që ne ta shohim pikën (a) para pikës (b). Për këtë arsye themi se Hëna nuk rrotullohet rreth boshtit të vet në raport me Tokën, sepse pikat (a) dhe (b) mbesin gjithmonë në të njëjtat pozita në raport me rrotullimin e tokës (shih figurën 36).

Fusha antimagnetike përkatësisht antigravitacionale që ka buruar nga toka e zhvlerëson idenë se ndonjëherë Hëna ishte pjesë e tokës, prandaj Hëna asnjëherë nuk ka qenë pjesë e tokës.

## Batica dhe zbatca

Forca e fushës antimagnetike ((-




Fig 36

B) ?) që buron nga toka në drejtim të Hënës ka një intensitet dhjetëra herë më të lartë se vetë fusha magnetike e tokës, prandaj kjo forcë nuk e lejon Hënë të përplasë për tokë ndërsa në të njëjtën kohë, nën veprimin e forcës shtytëse e shtynë ujin nga detrat dhe oqeanet në drejtim të Hënës (shih figurën 37).

Kështu që as forca gravitacionale e Hënës e as ajo e diellit absolutisht nuk ka asnjë ndikim në efektin e baticës dhe zbatcës.

Arsyeja se pse niveli i ujit ngritët në të dy anët e tokës bëhet nga fakti se forca tërheqëse e ciklonit të tokës e tërheqë Hënë në drejtim të tokës, kurse forca e fushës antimagnetike ((-B) ?) i kundërvihet kësaj force, prandaj vijat e fushës antimagnetike ((-B) ?) hasin në rezistencën e Hënës, kështu që kjo forcë transferohet në anën e kundërt të tokës, duke e ngritur nivelin e ujit në të dy anët.

## Shembull i thjeshtë

Një fëmijë dy apo trevjeçar në një distance prej 20 centimetrave është në gjendje ta fikë një qiri të ndezur mbi tortën gjatë festimit të ditëlindjes, por unë dhe shumë të tjerë nuk kam mundur ta fikim të njëjtin qiri duke e tërhequr ajrin, madje në një distancë prej më pakë se dhjetë centimetrave.

Prandaj ku mund ta tërheq fusha gravitacionale e Hënës dhe diellit ujin nga toka, këtë ligj e kanë vendosur ata që nuk kanë pasur asnjë lidhje me realitetin, dhe këto të pavërteta

mësohen fatkeqësisht edhe sot në të gjitha nivelet shkencore, dhe fatkeqësia më e madhe se përsëritet në ç'do kohë nga NASA, ESA ....turp të besohet në këto.

## Jeta në Mars iluzion apo realitet

Pasi që rreth planetit të Marsit rrotullohen dy trupa të vegjël, ekziston mundësia e prezencës së një fushe shumë të dobët magnetike dhe antimagnetike, por sa janë gjasat që njerëzit të dërgohen në Mars, edhe pse NASA pretendon që njerëzit mund të dërgohen për të jetuar në Mars, duke krijuar fusha magnetike përmes burimeve të ndryshme, gjasat janë afër zeros.

Por, le ta kuptojnë një herë e përgjithmonë ekspertët e NASA-s ESA-s, por edhe të gjitha agjencive të tjera hulumtuese, se as uji e as fusha magnetike artificiale nuk janë elementet e para për vendosjen e jetës në Mars. Absolutisht, fusha magnetike artificiale në planetin e Marsit nuk ka asnjë efekt pozitiv, përkundrazi ka efekte shumë negative në organizmin e njeriut. Fusha magnetike artificiale nuk e mbron aspak planetin e Marsit nga goditjet as nga rrezatimet, por shkakton pasoja katastrofale në organizmin e njeriut, nën veprimin e fushave antigravitacionale të diellit, tokës, por edhe të trupave të tjerë qiellorë, fushat magnetike artificiale do të jenë katastrofale për njeriun.

Dërgimi i njerëzve në Mars përmes anijeve fluturuese, të ngjashme me të tanishmet, që udhëtohet drejt stacionit hapësinor që ndodhet rreth 200 kilometra nga toka, është dërgim i njerëzve drejt çmendurisë.

Nëse tentohet që me anijet fluturuese të tanishme me të cilat udhëtohet në stacionin hapësinor, do të dërgoheshin njerëz në Mars, sado moderne që të jenë, nuk janë të pajisura me elementin bazë, i cili i mbron njerëzit gjatë udhëtimeve dhe qëndrimit në planetin e Marsit.

Këto anije fluturuese duhet të jenë të pajisura me gjeneratorë që gjenerojnë rrymë elektrike 24 orë. Nga kjo rrymë elektrike duhet krijuar fusha magnetike, prej të cilave do të përfitohet fusha antimagnetike.

Masa e kësaj pajisjeje është ekstrem e papërbalueshme për anijet fluturuese, prandaj teknologjia e tanishme përmes përdorimit të këtyre energjive nuk i plotëson kushtet e vendosjes së jetës në planetin e Marsit.

Prandaj, për ta vendosur jetën në Mars, ekziston një element kryesor që nuk e njeh NASA e asnjë agjenci tjetër e hulumtimeve që jeta në një planet të vendoset, është niveli i fushës antimagnetike që konsiderohet si kushtetutë e jetës në një trup qiellor.

E vetmja fushë antimagnetike është ajo që e mbron planetin e Marsit nga rrezatimet, kurse uji vjen si element i dytë i cili ndikon në rritjen e bimëve.

Për ta vërtetuar së pari se a posedon fushë antigravitacionale planeti i Marsit, duhet të dërgohen shumë bimë në vende të ndryshme dhe të provohet nëse ato rriten në formë vertikale apo shtrihen në sipërfaqe.

Nëse bimëve në Mars iu plotësohen kushtet dhe rrinë të shtrira në sipërfaqe, tregon se fusha antimagnetike e Marsit është e papërfillshme prandaj as që duhet të tentohet dhe shpenzohet për dërgime të njerëzve në planetin e Marsit.

Por, në të kundërtën, nëse bimët rriten në formë vertikale kuptohet se kemi një fushë antimagnetike, por sa do të jetë intensiteti i saj nuk e dimë, por nëse kemi një fushë të fortë antimagnetike ka mundësi që ta çrregullojë trurin e njeriut tërësisht, dhe njeriu të shndërrohet në makinë vrasëse, prandaj investimet do të dështojnë.

Prandaj, kthimi i planetit të Marsit në një planet të banueshëm do të bëhej lehtë përmes ndonjë filmi Hollivudian, por gjasat reale për dërgimin të njerëzve në Mars përmes NASA-s janë një hap i pamundur fare. **Vijon.**




Fig 37



Pas vizitës së Presidentit të Francës Emmanuel Macron në Beograd

# MACRON ME KOSOVËN GODITI NË ZEMËR TË SERBISË



**Ismet SYLEJMANI**

Presidenti i Francës Emmanuel Macron në vizitën e Tij më 15 korrik 2019 deklaroi në zemër të Serbisë në Beograd: "... Serbia dhe Kosova janë dy shtete fqinje..."!

18 vite pas bombardimit të NATO-s mbi Serbinë dhe caqet e saj ushtarako-policore në Kosovë, ishte për vizitë në Serbi njëri prej presidentëve të shteteve më të fuqishme të BE-së, Presidenti i Francës Emmanuel Macron!

Edhe Presidenti Macron sikur edhe të gjithë të tjerët personalitete të larta që ishin për vizita të niveleve të ndryshme në Beograd dhe gjetiu në Serbi, në një pjesë të fjalimit të Tij në lidhje me Kosovën, mbajti qen-

drimin tanimë ë njohur të Francës e të bashkësisë ndërkombëtare, por edhe të asaj pjese vendimëarrëse të BE-së! Nëpër histori ka qenë i njohur qëndrimi proserb i Francës!

Dhe ky qëndrim për patriotët dhe atdhetarët shqiptarë ka qenë shqetësues, sepse ndikimi në Europë e në arenën botërore i Francës jo vetëm ka qenë i madh por në shumë raste ka qenë edhe vendimtarë!

Franca ishte vendi ku u mbajtën konferenca botërore për fatin e Shqipërisë si ajo e Versajës dhe më vonë e Rambujesë!

Franca u bë vendi i madh në tokën e së cilës u vendos fati i tokave të popullit shqiptar, kufinjëve dhe të ardhmes evropiane të Atdheut e Kombit tonë!

Me luftën e UÇK-së kundër Serbisë pushtuese dhe bombardimit të NATO-s kundër Serbisë dhe makinerisë luftarake të sajë në zonat e luftës në Kosovë, qëndrimi i Francës përfundimisht ndryshoi në favor të luftës së drejtë të popullit shqiptar në ish-jugosllavi!

Franca për herë të parë, pa asnjë

ekuivok doli hapur kundër Serbisë në krijimin e Kosovës shtet të pavarur dhe sovran!

Ish-presidenti i Francës Sarkozy kishte bërë paraqitjen e rrallë para mediave botërore, ku shihet se si vizitoi një shkollë franceze dhe se si ju tregonte nxënësve të vegjël francez, se hartës së Europës dhe të botës po i ndryshonin kufinjët dhe se po i shtohet shteti më i ri Kosova!

Vizita e parë e një Presidenti të Francës në Serbi pas fletëarrestit që iu kishte lëshuar nga ana e Serbisë për Presidentin Shirak, ishte ngjarje e madhe e cila nga mediat botërore u vlerësua si një hap i madh ku Serbisë iu tregua përfundimisht nga aleati i sajë më i madh i deridjeshëm, se Kosova është vend i pavaruar dhe se me të jeni shtet fqinje!

Presidenti i Francës Emmanuel Macron, në Beograd ishte i qartë sa i përket faktit se Kosova është shtet fqinje me Serbinë!

Pas Shteteve të Bashkuara të Amerikës e Anglisë, Gjermanisë e Italisë, Franca përmes Presidentit Macron, në zemër të

Serbisë në Beograd, e tha qartë e fuqishëm se: "... Serbia dhe Kosova janë dy shtete fqinje..."!

Qëndrimi i Emmanuel Macron, Presidentit të Francës se kohërat kanë ndryshur dhe se duhet të pranohet realiteti i ri, ishte goditja e radhës kundër klasës politike e gjakëpirëse të vazhduesve të kriminelit e gjakëpirësit Milosheviq!

Qëndrimi madhështor i Presidentit Macron ishte mbështetje e madhe e forcave evropiane dhe progresive serbe, të cilat angazhohen për njohjen e realitetit të ri se Kosova nuk është dhe kurrë nuk do të jetë më nën Serbi!

Gjaku i derdhur për liri i luftëtarëve Heronjë e Dëshmorë të Atdheut dhe lufta heroike e titanike e popullit shqiptar të Kosovës kundër Serbisë pushtuese, atë ditë nga Presidenti Macron, nga qëndrimi i tij i mbajtur, është nderuar e respektuar lartë!

Populli shqiptar i Kosovës në veçanti dhe Kombi ynë në përgjithësi, përgjithmonë i jemi mirënjohës Presidentit Macron për qëndrimin e tij të guximshëm

që në zemër të Serbisë në Beograd, ti thuhet hapur Presidentit Vuçiq e nëpërmjet tij të tërë Serbisë dhe popullit serb, se Kosova është shtet dhe se çdo tentativë për të dalur kundër sajë është antieuropiane dhe antihistorike, e pasuksesshme dhe e destinuar të dështojë me turp!

Jehona e fjalimit të Presidentit Emmanuel Macron, që pas përfundimit të vizitës nuk do të shkojë duke rënë, por duke u rritur, sepse edhe aleati tradicional serb Franca e deklaroi në zemër të Serbisë në Beograd se: Serbia e Kosova janë shtete evropiane dhe duam që kjo të përkthehet në realitet".

Ndërsa Presidenti i Serbisë, Aleksandar Vuçiq, i zhgënjyer deklaroi se për Francën, Kosova është e pavarur, për Serbinë jo!

Pas epokës së UÇK-së, Kosova jo vetëm është në qendër të interesimit euroatlantik, por qëndrimi rreth sajë paraqet vlerën universale të fuqisë progresive të mbrojtësve të të drejtave të popujve që ishin të roberuar dhe tash janë të lirë e të pavarur!

**Prishtine, 23 korrik 2019!**

## Martohet Sean Gunn



**S**ean Gunn është një burrë i martuar. Aktori 45-vjeçar u martua me të dashurën e vet Natasha Halevi. Çifti u martua më 15 qershor në Kaliforninë Jugore dhe vëllai i Sean, James Gunn,

zyrtarizoi ceremoninë. Në mesin e mysafirëve të dasmës ishin Judy Greer, Jenna Fischer, Jennifer Holland, bashkëshortja e tij Keiko Agena dhe Amy Sherman-Palladino.

## Çka duan rusët nga Leonardo DiCaprio?



**F**ansat e Leonardo DiCaprios mund të jenë hutuar pasi kanë parë një mori komentesh të shkruara në alfabetin cirilik. Faqet e mediave sociale të yllit janë kapluar nga mijëra komente në tekstin cirilik duke i kërkuar yllit të "bëjë pjesën e tij për Liqenin

Baikal". Baikali është një liqen i madh në Rusi, për të cilin nga Fondi Botëror për Natyrën thuhet se është nën kërcënim nga ndotja dhe gjuetia. Llogaria e "Instagram"-it e DiCaprios është bombarduar me postime në rusisht duke kërkuar nga aktori ndihmë.



## Selena Gomez në Itali për ditëlindje

**S**elena Gomez festoi ditëlindjen e 27 në Itali. Këngëtarja dhe aktorja u vu re duke shijuar ditën në Romë. Selena ishte e shoqëruar nga disa miq, përfshirë producentin

Andrea Iervolino. "Selena erdhi me një grup miqsh. Ata po hanin karavidhe, makarona me salcë, vodka dhe sallata të ndryshme", ka pohuar një burim për "E!News".

## Young Dro arrestohet pasi sulmoi me puding të dashurën e tij



**R**eperi Young Dro u arrestua më 5 korrik për shkak se dyshohet se goditi në fytyrë të dashurën e tij, me puding të bananes, brenda shtëpisë së tyre në Atlanta. Çifti thuhet se ishin zënë

edhe më herët. Policët u thirrën në shtëpinë e tyre dhe ndonëse e dashura e tij nuk donte ta padiste, policia e arrestoi atë. Ai tani po përballlet me dy akuza për dhunë familjare.



moment kyç që ai kishte filluar të më shkruante edhe më tepër letra. Zakonisht letrat vinin me postë, apo ndodhte shpesh kur vinin dorë më dorë. Nga burgu delte ndonjë i burgosur dhe në këtë mënyrë shfrytëzohej rasti dhe i lëshuari nga burgu sillte letrat e pritura gjatë nga familjarët e tyre. Por, mënyra më e preferuar për të dërguar letra në shtëpi të burgosurit kanë preferuar këtë stil, kur dërgonin ndërresat për ti pastruar në shtëpi, në jakat e këmishëve fshihnin letrat për ti lexuar më vonë familjarët. Sidomos i fshihnin letrat që mbanin ndonjë fshehtësi. Kur kishin ndonjë porosi, apo kur kërkonin diçka të ndaluar. Shpesh në ato letra shkruheshin edhe torturat që iu bënin atyre gjatë hetuesisë. Ata që shkruanin këso letra nuk ishin të pakt. Gjatë leximit të letrave shumë më vonë kam kuptuar se babai im, më së tepërmi më kishte dërgua këso letra, nëpërmes të jakave të këmishëve.

Disa nga ato letra edhe ishin zbuluar, edhe ishin konfiskuar, e për ato babi shpesh e kishte paguar një kosto të madhe, duke e futur në qeli të ftohta dhe të errëta-burg. E kishin veçuar duke e mbajtur me muaj të tërë pa dëgjuar as një zë njeriu, veç zërit të ashpër të gardianëve. Shpesh kishte ndodhur, tek të burgosurit, që nga qelit e tilla të mos dalin normal, ose të çmendeshin fare. Më kishte tregua njëherë babai se nga çmenduria e kishte shpëtua vetëm një pikim i ujit që kishte rrjedhur vazhdimisht në qeli...

Megjithatë, babai im kishte arritur t'iu sfidojë të gjitha atyre torturave, dhe kishte mbërritur që të më shkruante edhe letra, jo letra do si do, por letra të gjata burgu, në burg. Ende qëndroja në këmbë dhe shtrëngoja sa mundja letrat në gjoks sa për një moment ndjeva dhembje në kraharor. Isha e shastisur. Nuk e dija se çfarë mund të ketë në to, por një zë nga brenda më thoshte se duhet ti lexoja, por, kur... dhe si... Ende nuk kisha vendosur. Për ti hapur ato më nevojitej një kurajë fortë e madhe, e ajo tani për tani më mungonte. Për një moment ndjeva angështi. Hapa dritaret dhe ndjeva se si diku larg këndonte një kanarinë.

Kishte kohë që më kishte ikur babai, dhe tani në këtë natë të vonë më kthehej në formën e shkruar. Nuk dija a të gëzohem apo të bërtas, por dashuria për të, më erdhi edhe tani në mënyrën më të valët, dhe një zë më thoshte- hapi letrat... hapi letrat... se ai është aty... në rreshtin e shkruar...

Kishin kalua orë, e unë qëndroja e shtangur. Në dhomë kishte fillua të depërtonin

rrezet e purpurta e nga kati tjetër i shtëpisë dëgjoja se më thërriste motra. Assesi të kujtohesha se ku isha, assesi të largohesha nga kujtimet që më kthyen vite e vite mbrapa. Lëvizja si somnambul nga dhoma në dhomë, hapja dritaret krah më krah dhe diku si në kllapi dëgjoja zërin e babait që më thirrte jashtë, kah vinte flladi pranveror. Edhe më tej qëndroja e shastisur dhe assesi të vendosha me i lexua ato letra. Sillesha vërdallë, prej dhomë në dhomë, nga dora nuk i lëshoja, i mbaja me vete duke i shtrënguar fortë. I shikoja me kujdes dhe i rrotulloja duke u frikësuar se do thyeja diçka brenda tyre. Do i lëndoja pa dashje... Më kishte tregua gjyshja edhe këtë, se pas lindjes sime, pas ca muajve nëna kishte pasur një hemorragji të papritur, dhe medet... ajo kishte ikur për diku... e gjyshja ime kurrë nuk e përmendte fjalën - vdekje. Babai kishte pësuar thyerje shpirtërore. Shumë kishte vuajtur për humbjen e saj. Por edhe më shumë iu kisha dhimbsur unë, që kisha ngelur pa mama, besa edhe jeta ime kishte qenë në rrezik, por falë gjyshes dhe kujdesit të saj jam këtu ku jam.

Pastaj, në Vendin e Shqipeve kishin ardhur shumë ushtarë më thoshte gjyshja, dhe kishin bërë kërde në popull. Babi nuk ishte pajtuar me ta dhe me sjelljet e tyre prej barbari. Ata kishin kërkuar drithin nga fshataret, kishin kërkuar edhe mishin, edhe vezët edhe çdo gjë tjetër që ata nuk e kishin as për vete. Kur fshataret nuk i dorëzonin në ditën e caktuar, ata i ndëshkonin rëndë. Vinin me milic dhe me do farë kampanjolla, iu thoshin, thoshte gjyshja. Ishin ca vetura të tmerrshme ku aty i futnin fshatarët dhe i dërgonin në burgun e qytetit. I mbanin me orë të tëra të mbyllur. I keqtrajtonin, i rrihnin me shkopinj gome, me shkelma e me grushte, derisa binin në alivani.

- Oh, moj loke, kur dilnin nga aty të futnin datën, ishin të mavijosur, me fytyrë e trup. Vinin në shtëpitë e tyre dhe është e çuditshme se si ata heshtnin, nuk bëzanin, nuk e thoshin asnjë fjalë. Grumbullonin drithin që e kishin ruajtur me aq kujdes dhe e dorëzonin tek odbornikët e fshatit. Radha na kishte ardhur edhe neve, dhe duhet dorëzuar i tërë bereqeti që e kishim. Ishin kohë të

vështira, njerëzit vdisnin nga uria e ne e ndihmonim pushtetin që nuk e llogaritëm asnjëherë për tonin.

- Një ditë, Liri u kthye vonë nga qyteti. Ishte i rraskapitur dhe nuk foli gjë. Drejtën të them, diçka më sëmboi në shpirt. Kishte ndërrua çehre djali im. Shumë - shumë më vonë më ka tregua se po atë ditë e kishin marr në pyetje hijet e zeza. Ai kishte reaguar, nuk ishte pajtuar me ta. I kishin thënë që t'iu ndihmonte. Babai i kishte pështyrë në fytyrë dhe hapur iu kishte thënë se nuk pajtohet me rendin kolonialist që po venin në Vendin e Shqipeve. Ata iu kishin kërcënuar duke i thënë, pse nuk ikni nga këtu, organizo fshatin dhe shkoni për në Anadoll. Ai i kishte shikuar i habitur, duke mos iu besuar fjalëve që kishte dëgjuar. Atë ditë erdhi në fshat, por nuk qëndroi duarkryq. Thirri parin e fshatit, i njoftoi se çfarë kishte dëgjuar, por në fund i porositi "Ne duhet të qëndrojmë dhe të jemi sa më të bashkuar".

Merre me mend, moj Martinë, po atë natë ende pa gdhirë, shtëpinë e kishin rrethkuar forca të mëdha policore. I mëshonin dyerve dhe thirrin

sa mundnin "otvoritevrata" (hapeni derën) thoshin ata. Ne ishim të trishtuar se nuk dinim se çfarë po ndodhte. I thyen dyert, u futen si bishat dhe e kapën Lirin ashtu nëtli- na duke i lidhur të dy duart me kllapa pas shpine. Të gjithë u zgjuam, fëmijët tjerë bërtitnin, e ai babai yt, qëndronte me duar të lidhura në mesin e dhomës. Ata e shtyn brutalisht, e detyruan që të ecë para dhe e futën në maricën ngjyrë mavi. Ne ngelëm të habitur, nuk kuptonim assesi ishte ëndërr apo zhgëndërr këtë që pamë. Dhe nga ajo ditë Liri u arrestua për të dal vetëm pas pesëmbëdhjetë viteve. E akuzuan, se kishte formua një organizatë ilegale dhe se kishte dashur të shkatërronte shtetin që ekzistonte në tokën e Shqipeve. E shef se nata kishte vesh e dita kishte sy dhe se çdo gjë përcillej sa çel e mbyll sytë.

Derisa rrija shtrirë në shtrat dhe me orë të tëra mendoja se kur do të filloja ti hapja letrat edhe tani si për inat më vinin rrotull fjalët e gjyshes.

- Duhet pasur kujdes nga armiku, pa marr parasysh se me çfarë petku paraqitet, dhe vërtet vitet në vijim e dëshmuar këtë...



## 'Tana Production' hap konkurs për tekste dramatike

Organizata për kulturë "Tana Production", në kuadër të aktiviteteve të veta, ka shpallur konkurs publik për tekste dramatike. Konkursi do të jetë i hapur nga sot e deri më 03. 08. 2019. Tekstet e përzgjedhura nga juria profesionale do të lexohen në mënyrë

skenike nga aktorët e mirënjohur shqiptarë. Leximet skenike do të zhvillohen në kuadër të festivalit të kulturës dhe traditës shqiptare "Etnofest", që do të fillojë më datën 20 gusht 2019 në fshatin Kukaj. "Tana Production" inkurajon dramaturgët e

rinj që të marrin pjesë në këtë konkurs publik që, përpos leximit skenik, synon edhe promovimin e teksteve dramatike. Tekstet dramatike mund të dërgohen në këtë adresë elektronike: productiontana@gmail.com.

# A kishte sozi Enver Hoxha dhe

## Mjeku personal i diktatorit zbulon gjithçka

Isuf Kalo, mjeku i diktatorit Enver Hoxha, ka dhënë një intervistë për gazetarin Roland Qafoku në emisionin "Debati në Channel One".

**Doktor Kalo, mirë Enverin e mjekuat dhe e shëruat po vetë si je me shëndet? Si ia ke dalë që ta mjekosh diktatorin duke kaluar stres, preukopim dhe mbi të gjitha frika se mos ju ndodhte juve diçka?**

Me shëndet jam mirë. Jam mirë akoma. Jam 77 vjeç, kam dalë në pension por pavarësisht vijoj aktivitetin. Besoj ka edhe të tjerë si unë që duke qenë aktiv në jetën profesionale dhe pedagogjike, publicistike, jeta e ruan ritimin e saj. Vitet e Bllokut ishin vite kur unë isha shumë i ri.

**Si mendoni, a ishit ju fatkeq apo fatlum që i shërbyet Enver Hoxhës? Si e përcaktoni sot atë që bëtë?**

Po të kthehemi në kohë ishte një detyrë e pabesueshme. Ishte fat i madh. Më shumë se një person real, Enver Hoxha ose siç i thoshim ne shoku Enver ishte një mit. Gëzonte të paktën në aparencë. Sapo mbarova fakultetin e Mjekësisë kërkoja të filloja sa më shpejt në punë. Por nuk po kuptoja që pse emërimi im po vonohej. Isha nevojtar sepse kisha gjëndje jo të mirë ekonomike. Më kishte vdekur babai gjatë viteve që isha në fakultet dhe më par më kishte vdekur një vëlla. Ishim 8 fëmijë dhe me vetëm nënën me një gjysmë pensioni ishte shumë vështirë jetesa. Kisha ardhur në Tiranë nga Luzati i Tepelënës që në moshën 5-vjeçare.

Edhe pse jetoja në Tiranë merrja një gjysmë bursë. Në këtë mënyrë më bëri që nga kjo vonesë të shkoja të interesoheja. Shkova në ministrinë e Shëndetësisë dhe kërkoja përse nuk po më emëronin. Personi që takova më tha që në pritje të emërimit mund të filloja provizorisht në një punë. Por kjo më habiti edhe më shumë. Të gjithë të tjerët e diplomuar kishin filluar punën, ndërsa unë jo. Nuk kisha asnjë pretendim. Doja punë. Por papritur më thërrasin dhe më thonë që isha emëruar në klinikën speciale. I paditur se çfarë ishte pyeta; Ku është kjo në Tiranë? Pa e ditur që nga ai moment e deri në vitin 1991 do punoja aty dhe nuk e kam ndërprerë asnjëherë punën po

nga aty. Ai që më lajmëroi më tha që kisha qenë me fat.

**Si mendoni ju përse ju përzgjedhën pikërisht juve?**

Unë mendoj se kisha rezultate të mira në mësimet dhe se karaktersitikën e mirë. Një nga arsyet ishte se familja ime kishte shumë anëtarë partie. Ndërkohë kisha dy vëllezër ish-partizanë dhe tre vëllezër të tjerë anëtarë të partisë. Biografia ime ishte shumë e mirë, shumë solide.

**Sa vjeç ishit kur filluat punë në klinikën speciale të Bllokut?**

23 vjeç. Dhe gjatë gjithë kohës punova aty në klinikë. Në vitin 1973 më thirri Hysni Kapo dhe më tha se Partia të ka besuar një detyrë shumë të rëndësishme, të jeni mjek personal i shokut Enver. Ishte e pabesueshme për mua dhe shqetësim. Hysni Kapo më tha që mos të shqetësohesha se profesor Fejzi Hoxhën do ta kisha mbështetje. Madje edhe atë vetë do ta kasha mbështetje. Që nga ai moment u fillova punën mjek personal i Enver Hoxhës. Ka qenë 9 korrik 1973 kur nisa këtë detyrë.

**Keni shkruar në libër që këta lloj mjekësh që mjekonin diktatorin cilësoheshin si veterinerët që mjekonin kafshët e egra në kafaz në kopshtin zoologjik. Pra kishin rrezikun brenda. Ok profesor Kalo, ju ishit veterineri, por ata që mjekuat jua çfarë lloj kafshësh ishin?**

Jo, nuk e kam thënë. Unë kam cituar një mjek të huaj që në një takim në Paris më provokoi duke ma thënë këtë shprehje. Ai më tha jam kurioz, ti kur shkon dhe viziton këta personalitete, a e ke ndjerë ndonjëherë veten si veterineri që hyn brenda në kafaz? Unë i thashë jo, nuk e kam menduar asnjëherë.

**Në atë kohë unë e kuptoj që doemos kështu do ta thoshit, po sot a keni të njëjtën përgjigje apo mendoni ndryshe?**

Edhe sot mendoj njësoj. Nuk e kam menduar. Nuk e kam patur këtë frikë. Ata ishin shumë të sjellshëm.

**Doktor Kalo, nëse do e përmbledhni me një fjalë çfarë ishin njerëzit e Bllokut, përbindësia kriminelë apo bamirës dhe heronj?**

Unë do të thosha se ata ishin

njerëz si të gjithë ne. Nuk pashë që dikush prej tyre të kishte dhunti ekstraordinare. Por ata kishin fat ndryshe nga ne. Disa patën fat të çuditshëm që nga askush u bënë dikush, ndërsa disa nga dikush u rrëzuan në humnerë pa e ditur edhe ata përse. Përzgjedhja ishte bazuar në kriteret e besueshmërisë dhe jo të zotësisë. Është gabim si perceptojmë sikur këta ishin monstra. Sepse kështu do quhej aksident gjenetik. Dhe kjo lindte supozimin e ndodhi një herë dhe nuk mund të ndodhë gjithmonë. Por një pjesë e tyre ishin të sjellshëm qoftë edhe për fasadë. Sepse morali komunist kështu e kërkonte.

**Ju e keni shkruar në libër që Enver Hoxha ishte diktator dhe të gjithë në Bllok ishin ashtu. Por sot pas kaq vitesh a ndjeni brengë që keni mjekuar një diktator dhe i keni zgjatur jetën atij dhe në një farë mënyre i keni zgjatur jetën diktaturës në Shqipëri?**

Por kjo është një çështje etike dhe deontologjike. Unë nuk konkurova për të qenë mjek i Enver Hoxhës dhe as mjek i klinikës. Mua më emëruan, mora një detyrë shtetërore. Unë e quajta fat. Unë Enver Hoxhën nuk e kam trajtuar si një person i jashtëzakoshëm. Unë e kam trajtuar si pacient. Mjeku nuk ka një pacient më të mirë dhe një pacient më të keq. Një mbret i tha mjekut do më mjekosh më mirë se ushtarët. Mjeku i tha, jo, unë ushtarët i mjekova si mbretër. Nuk kam brerje ndërgjegje dhe e kam patur krenari që kam qenë mjek i tij.

**Në atë kohë që ishit krenar unë e kuptoj. Por tani a vazhdoni të ndjeheni krenar? Me atë që lexova në libër unë kuptova që ju keni brerje ndërgjegje. U ngrit një system diktaoprial që vuajti populli.**

Që Enveri ishte diktator dhe regjimi ishte diktatorial kjo ishte e shpallur nuk do ta zbuloja unë. Por unë nuk mjekova diktaturën por unë mjekova diktatorin. Edhe po të mos ishte Enveri dikush tjetër do zëvendësonte atë, një Enver tjetër, një diktator tjetër. Sepse sistemi do të thoshte diktaturë. Nuk ishte diktator vetëm Enver Hoxha. Diktator ishte drejtori i shkollës, drejtori i ndërmarrjes. Diktator ishin edhe burrat në familje.



**A ishit ju i privilegjaur dhe i përkëdhelur nga sistemi komunist?**

Mua më vjen zor të them që nuk isha. Po ta krahasosh me ata që vuanin unë isha shumë ndryshe. Por unë nuk kam qenë më mirë i paguar se të tjerët.

**Sa ishte rroga juaj?**

Rroga ime ka qenë si e çdo mjeku.

**Sa merrnit ju kur ishit mjek i Enver Hoxhës?**

Paga ime ishte 8 mijë lekë të vjetra.

**A merrnit suplement?**

Jo. Nuk kishte. Fat i madh ishte që unë shkoja jashtë shtetit. Për të parë botën dhe specializim. Por kur kujtoj vajzën që kur mbushi 20 vjeç më tha babi më ke munguar shumë, jam ndjerë keq. Pastaj po të llogaritësh që nuk kam qenë kur më vdiq im vëlla..... Orari ishte 8 orë, por në fakt isha 24 orë në punë. Isha i monitoruar.

**Prandaj unë ju pyeta në fillim si keni qenë me shëndet? Megjithatë kam qenë mirë.**

**A e keni shkelur betimin e Hipokratit duke shkruar këtë libër?**

Absolutisht jo. Unë nuk kam punuar duke u betuar në betimin e Hipokratit. Por kam punuar me ndërgjegjen dhe impenjim.

**Si ka mundësi që ju në libër shkruani për barazi varfërie në Shqipëri kur në fakt rreth 100 mijë shqiptarë vuajtën nga ai regjim 50-vjeçar duke i pushkatuar, burgosur dhe përndjekur? A i thatë ndonjëherë pacientit tuaj Enver Hoxha që përveç kësaj barazie në varfëri pushkatoheshin dhe burgoseshin njerëz për shkak të bindjeve dhe ky ishte krim masiv?**

Ju e prisni këtë që tia thoshte doktori? Apo prisni që tia thoshin shokët, e shoqja, fëmijët? Me këtë pyetje ju tregoni se nuk dini asgjë çfarë përfaqë-



# e si nuk iu bë kurrë atentat?



sonde ai regjim. Hysni Kapo më tha shërbeji mirë atij dhe populli do të jetë përjetë mirënjohës.

**A u është mirënjohës populli shqiptar juve?**

Nuk e di. Di që askush nuk mund t'ia thoshte Enverit diçka që nuk shkonte. Dikush që ia ka thënë përfundoi keq.

**Si ka mundësi që edhe përpara togës së pushkatimit unë kam lexuar që armiqtë dhe kundërshtarët e Enverit thërrishin Rroftë Enver Hoxha, të Rrojë Partia! Si ka mundësi?**

Sepse ata besonin që ai regjim do ishte i përjetshëm. Kishin shpresë që e drejta e tyre do dilte. Nëse ata dënonin Enverin ata merrnin vulën e përherëshme. Ata luteshin dhe qanin si Petrit Dume, madje edhe Kadri Hazbiu. Ose nuk kishin njohur mekanizimin se ai Enver i funksiononte se kishin shpresë që e drejta e tyre do dilte. Ata e kanë ndjerë vetë që janë dënuar me pa të drejtë ose gabimisht.

**A kishte sozi Enver Hoxha?**

Jo. Të paktën sa kam shërbyer unë kurrë nuk di qetë dikush të ketë bërë sozinë e tij

**Një student më pyeti një ditë, kur ishte kaq gjakatar regjimi komunist, dhe Enver Hoxha një përbindësh si ka mundësi që nuk iu bë asnjë atentat? Si ka mundësi që nuk u qëllua as me lastiqe?**

Nuk bëhej fjalë. Enveri nuk mbante kurrë antiplumb dhe nuk ruhej siç mund të ishte perceptimi. Nëse dikush do të dionte ti bënte diçka mund t'ia bënte shumë lehtë. Unë kam qenë atje dhe e njihja masën e sigurisë. Ai futej në mes të turmës dhe nuk kishte asnjë droje. Nuk kishte fare rrezik. Truprojat ishin të thjeshtë pa ato teknikat e njohura që kanë.

**A ishte Sulo Gradeci, komandant i grupit të shoqërimit të Hoxhës, një njeri i zoti që vërtetë i mbronte jetën?**

Ai ishte shumë i zgjaur, por jo se kishte ndonjë teknikë të lartë

për mbrojtjen e Enverit. E thashë, nëse dikush do të donte ti bënte diçka Enverit mund t'ia bënte?

## PËR VDEKJEN E MEHMET SHEHUT

Zoti Kalo përse e keni kaluar tangent në libër vdekjen e Mehmet Shehut. Madje keni dhënë një lloj sigurie që ishte vetëvrasje kur faktet flasin ndryshe? Janë disa fakte që e konfirmojnë që Mehmet Shehun e vranë por një fakt është mbi të tjerët: Ekspertiza balistike cilëson se e ka qëlluar veten me dorën e majtë, eksperiza mjekoligjore cilëson se e ka qëlluar veten me dorën e djathtë. Mjafton vetëm kjo për të thënë se gjithçka është e manipuluar.

Unë nuk jam mjek hetues. Unë kam folur me shumë imtësi me doktor Hariton disa herë dhe ai më ka thënë 200% se kjo është vetëvrasje. Nëse ekspertiza e letërës që ka lënë Mehmeti vërtetohet katërcipërisht e shkruar me dorën e tij, këtë nuk mund ta

ketë shkruar vrasësi. Kjo i mbyll të gjitha. Unë kam dhënë versionin tim, logjikën që të çonte që vetëvrasja ishte një nga opsionet e fundit dhe e vetme që i kishte mbetur Mehmetit për të minimizuar pak vështirësitë e situatës që ishte krijuar. Unë nuk aludoj fare sepse bazohem mbi këtë logjikë. Nuk ishte një vetëvrasje nga emocioni apo frika dhe dëshpërimi. Ishte një akt negocimi "unë po iki nga jeta sepse e kuptova që unë pengoj por vetëm do më plotësoni këto, këto, këto gjëra dhe i la të shkruara. Fatos Harito më thotë që i biri i Mehmetit, Bashkimi ka ardhur nga Spanja për këtë punë, i ka marrë të gjitha argumentat dhe ka ikur plotësisht i sqaruar.

**Si u zhdruk infermierja e Mehmet Shehut menjëherë pasi ai u gjet i vdekur?**

Nëse i referohemi librit unë kam dhënë racionalitetin se si zhvillohen ngjarjet dhe pse kishte logjikë që kjo ishte vetëvrasje. Mehmeti e vrau veten atë natë

kur nuk kishte mbaruar procesi i dënimit të tij. Kush tha që u zhdruk infermierja e Mehmetit?

**Ku është? Ku shko?**

Tani po diskutojmë librin tim dhe jam i mendimit se ishte vetëvrasje.

**Gabon vëllai i Mehmetit?**

Nuk e di, nuk e njoh.

**Vëlli i Mehmetit, Duro Shehu është i bindur që kjo është vrasje dhe e ka shkruar në kujtimet e tij se i vëllai është helmuar dhe më pas është vranë. Duro Shehu shkruan se nuk mund të vrasë njeriu veten me dy plumba në zemër.**

Unë në libër nuk merrem shumë nëse është vrasje apo vetëvrasje. Për mendimin tim me Mehmet Shehun u nis një vendim që quhet eliminim, i cili është një proces cili ndiqet shkallë-shkallë i cili përveç se jetës të merr të gjitha meritat. Fati i Mehmetit është vendosur qysh në 15 ditëshin e parë të muajit shtator pas 4 takimeve që ai bëri me Enver Hoxhën dhe Nexhmijen në të cilat Enveri i propozoi Mehmetit që për ta mbyllur gojën dhe opinionin të pranonte ta dënonte djalin, të hiqej sikur nuk kishte pasur dijeni për fejesën. Me këtë ai thoshte se do shpëtonte opinionin e partisë që mos mendojnë njerëzit se ndryshe themi, ndryshe bëjmë. Mirëpo Mehmeti nuk pranoi. Tha: Jo, gabimin e bëra unë sepse djali im më pyeti. Kjo ishte e kundërta e asaj që donte Enveri. Vrasja nuk ishte një akt që i shërbente Enverit ndaj Mehmetit sepse krijonte histori, krijonte zhurma pas, kurse eliminimi bëhej dalëngdalë duke i hequr nga kryeministër, drejtor ferme etj. Mehmeti e prishi këtë plan. Ai e kuptoi që një ditë do përfundonte keq. Unë jam i bindur se ishte vetëvrasje.

**Doktor, ky është aludim nuk është fakt. Faktet janë fakte, ato nuk janë as të miat dhe as tuajat. Mehmet Shehu është vranë.**

Ky është mendimi juaj. Unë nuk mendoj kështu.

**Ka një fakt që më ka habitur nga ajo që e sillni në librin tuaj. Në materialet që iu gjetën Mehmet Shehut në zyrë pasi u gjet i vdekur ishte edhe një revistë pornografike dhe një disk me pamje filmike pornografike. Çfarë ishte kjo?**

Edhe unë jam habitur. Mehmeti nuk jepte shenja dhe të dhëna që të ishte pas fustaneve. Ky fakt më ka habitur. Unë kam patur shumë kontakte me të dhe e kam vizituar, por nuk më ka lënë asnjë mendim në këtë aspekt. Por kjo kështu ka qenë.

/ gazeta-shqip.com /

**E jashtëzakonshme**

## Thyen rekord, gruaja qëndroi katër orë duke bërë 'plank'

Dana Glowacka është një grua nga Montreali, e cila kohët e fundit ka vendosur rekordin e ri të mrekullueshëm botëror për plank të grave, duke qëndruar për 4 orë e 20 minuta. Rekordi paraprak botëror ishte 3 orë e 30 minuta, që do të thotë se Glowacka e theu rekordin për gati një orë.



**FOTO E DITES**



Zjarrfikësit përpiqen të shuajnë një zjarr në afërsi të fshatit Cardigos në Portugali. /AP/

**E rrallë**

## Transplantohet kafka e parë plastike e bërë me printer 3D

Një vajzë 22-vjeçare nga Holanda vuan nga një sëmundje kronikë e çrregullimit të kockave, asaj i është shtuar trashësia e kafkës nga 1.5 cm në 5 cm, duke i shkaktuar kështu dhimbje të tmerrshme të kokës dhe dobësim të shikimit. Për këtë arsye, mjekët ia hoqën pjesën e sipërme të kafkës dhe ia zëvendësuan me një pjesë që e printuan me material plastike, në



një printer 3D. Operacioni u krye nga një ekip neurokirurgësh në Universitetin e Utrehtit, të cilët thonë se kjo është hera e parë që transplantohet një kafkë e printuar me 3D.

**BARSOLETA E DITËS**



**Polici:** A e di se për ta ngarë makinën 200 km/h është e jashtëligjshme?  
**Shoferi:** Po.  
**Polici:** E pse nuk ndalove kur unë të ndiqja?  
**Shoferi:** Pasha Zotin mendova se je duke dashur të shtyhesh me mu.



**Programi i shfaqjes së filmave në Kino ABC**

**Ne ora 16:00 (vikendit ne ora 14:00 dhe 16:00)**  
**“THE SECRET LIFE OF PETS 2” 3D**

I Animuar/Aventurë/Komedi; 1 ore 26 min  
**Rolet:** Kevin Hart, Tiffany Haddish, Harrison Ford, Patton Oswalt, Eric Stonestreet, Jenny Slate, Lake Bell, Hannibal Buress, Nick Kroll, Dana Carvey, Ellie Kemper, Pete Holmes, Garth Jennings, Bobby Moynihan  
**Regjia:** Chris Renaud and Jonathan Del Val



**Ne ora 18:00**

**“X-Men; Dark Phoenix”**

Aksion/Aventurë/Sci-Fi; 1 orë 53 min

**Rolet:** James McAvoy, Michael Fassbender, Jennifer Lawrence, Nicholas Hoult, Sophie Turner, Tye Sheridan, Alexandra Shipp, Kodi Smit-McPhee, Evan Peters, and Jessica Chastain  
**Regjia:** Simon Kinberg



**Në ora 20:00**

**“MEN IN BLACK; INTERNATIONAL” 3D,**

Aksion/Komedi/Sci-Fi; 1 orë 55 min

**Rolet:** Chris Hemsworth, Tessa Thompson, Kumail Nanjiani, Rebecca Ferguson, Rafe Spall, Laurent Bourgeois, Larry Bourgeois, Emma Thompson, Liam Neeson  
**Regjia:** F. Gary Gray




**Ne ora 22:00**

**“M A”**

Horror/Triller; 1 ore 39 min

**Rolet:** Octavia Spencer, Juliette Lewis, Diana Silvers, Luke Evans, McKaley Miller, Missi Pyle, Corey Fogelmanis, Gianni Paolo, Dante Brown  
**Regjia:** Tate Taylor



**Për informata dhe rezervime të biletave thirrni FALAS: 0800 22 222 dhe boxoffice@kinoabc.info, www.kinoabc.info, fb: Kino ABC.**

 <p><b>DASHI</b> Gjërat e vogla të jetës janë ato që ju mbajnë në humor dhe që ju japin energji për të përballuar çdo problem të ditës.</p>	 <p><b>DEMI</b> Një pjesëtar i familjes suaj do të ketë nevojë për praninë tuaj sot. Anashkaloni çdo gjë tjetër për t'ju gjendur pranë.</p>	 <p><b>BINJAKËT</b> Edhe ju mund të lodheni nga rutina e përditshme dhe doni të bëni diçka ndryshe. Kërkoni opsione që mund t'ju kënaqin.</p>	 <p><b>GAFORRJA</b> Sot nuk do të jetë zgjidhje e mirë të lini përgjysmë një projekt të nisur. Bashkëpunëtorët tuaj do të ecin shumë përpara jush.</p>	 <p><b>LUANI</b> Këtë periudhë keni qenë shumë të impenjuar të zgjidhni çështje urgjente profesionale dhe kjo ka ndikuar për keq në humorin tuaj.</p>	 <p><b>VIRGJERESHA</b> Nuk ju mbetet shumë për t'u menduar sot, sepse çdo gjë që keni vendosur ka marrë drejtim. Ju mbetet veç të shijoni kohën.</p>
 <p><b>PESHORJA</b> Momentet tuaja më të mira sot do t'i kaloni në shoqërinë e miqve të mirë, por që i takoni rrallë për shkak të largësisë.</p>	 <p><b>AKREPI</b> Edhe pse nuk doni të shfaqeni sot do të jeni pjesë e rëndësishme në realizimin e një ëndrre të hershme të partnerit.</p>	 <p><b>SHIGJETARI</b> Jo gjithmonë keni qenë të aftë të fitoni besimin e personave afër jush. Për këtë arsye sot do të merrni disa kritika konstruktive.</p>	 <p><b>BRICJAPI</b> Edhe të tjerët kanë limitet e tyre kështu që jo gjithmonë duhet të jenë në favor të zgjedhjeve dhe humorit tuaj të momentit.</p>	 <p><b>UJORI</b> Po vini në zbatim disa ide të rëndësishme, por do të hasni në pengesa nga persona që nuk ju a priste mendja se mund t'ju pengonin.</p>	 <p><b>PESHQIT</b> Keni vënë piketat për çështjet më të rëndësishme që do të merreni sot. Ju kanë mbetur vetëm detajet për të përcaktuar.</p>

**EURO GLASS**  
SAINT-GOBAIN  
SEKURIT PILKINGTON  
Enveri

Adr: Fushë Kosovë  
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336  
E-mail: euro.glass@live.com



**QENDRA SPORTIVE**  
"BUJQËSIA"  
TEL: 045/82 82 82

# Feronikeli kërkon rezultat pozitiv në Sllovaki



Kampionët e Kosovës sot përballen me Slovan Bratislavën në Ligën e Evropës. Feronikeli, pas dështimit befasues në Ligën e Kampionëve, tash po kërkon një rezultat të favorshëm nga ndeshja e parë në mënyrë që kualifikimi të sigurohet në ndeshjen kthyesë, e cila zhvillohet më 30 korrik në stadiumin "Fadil Vokrri"

**EPOKA ERE** **Veton ZYMBERI**

**PRISHTINË, 23 KORRIK** - Kampioni i Kosovës në futboll, Feronikeli, aventurën ndërkombëtare do ta vazhdojë në Ligën e Evropës. "Nikli" sot (e mërkurë) nga ora 18:00 përballen me skuadrën e Slovan Bratislavës në "Tehelne Pole". Përballja në mes të skuadrës sllovaqe dhe asaj nga Drenasi është në kuadër të rrethit të dytë të Ligën e Evropës.

Sulmuesi Kastriot Rexha është optimist se "Nikli" do të paraqitet më mirë në këtë garë dhe rezultatet të jenë më pozitive se në Ligën e Kampionëve. "Në Ligën e Evropës do të bëjmë lojërë të mira sikurse në Ligën e Kampionëve, por besoj se do të marrim edhe rezultate më

të mira", ka thënë Rexha për gazetë. Sulmuesi prishtinas e vlerëson si të fortë skuadrën sllovaqe, por beson se rezultati pozitiv është i arritshëm. Feronikeli u eliminua nga Liga e Kampionëve, pasi humbi ndeshjen kthyesë në Prishtinë nga The NeW Saints (0-1), derisa ndeshja e parë në Uells kishte përfunduar me rezultat 2-2.

Për ndeshjen e sotme ka folur edhe sulmuesi Mevlan Zeka, i cili beson se skuadra e Feronikelit mund të marrë rezultat pozitiv në ndeshjen e parë. "E dimë se Slovani është skuadër me cilësi të larta, por në futboll asgjë nuk është e pamundur. Ne nuk dorëzohemi dhe do të mundohemi të japim më të mirën nga vetja secili prej nesh dhe në fund të shohim", ka thënë Zeka, i cili në ndeshjen ndaj TNS-së

ishite titullar në formacionin e kampionëve të Kosovës.

Ndeshja kthyesë zhvillohet më 30 korrik në stadiumin "Fadil Vokrri" në Prishtinë. Kjo ndeshje pritet të përcillet me tensione, pasi mediet serbe kanë raportuar se Komiteti Serb i Futbollit u ka kërkuar dy futbollistëve serb Aleksandar Qavriq dhe Dejan Drazhiq ta bojkotojnë duelin ndaj Feronikelit. Të njëjtën gjë serbët kishin kërkuar edhe në ndeshjen në mes të Malit të Zi dhe Kosovës në kuadër të kualifikuesve për Kampionatin Evropian. Ky presion ndikoi që dy lojtarët serb dhe trajneri ta bojkotojnë atë ndeshje. Pjesë e Ligës së Evropës në këtë edicion ishte edhe skuadra e Prishtinës, e cila u eliminua pas humbjes në ndeshjen e kthimit ndaj St Joseph's (2-0).

## SHKURT

### Stade Brestois dhe Dijon në kërkim të Grezdës

Reprezentuesi i Shqipërisë, Eros Grezda, pritet të largohet nga Glasgow Rangersi, pasi nuk arriti të lë gjurmë në këtë skuadër. "Scottish Sun" raporton se interesim për lojtarin shqiptar kanë treguar dy skuadrat franceze Stade Brestois dhe Dijon. Rangersi kishte paguar dy milionë euro për Grezdën, kurse mund ta shesë atë për 1.5 milion.

### Mundësi Qaili mposhtet nga Nikopolidisi

Mundësi Urim Qaili ishte i pafat në përballjen me grekun Konstantinos Nikopolidisi në Festivalin Olimpik Evropian për të Rinj, "Baku 2019". Garuesi i Kosovës pësoi humbje në kategorinë -65 kilogramë. Përvoja e fituar në këto gara do t'i shërbejë Qailit për garat e ardhshme ndërkombëtare.

### Kallaba dhe Dushi përforcojnë Bashkimin

Bashkimi i Koretinit, pas marrëveshjes me trajnerin Emin Bajrami, ka arritur marrëveshje edhe me futbollistin e njohur Blend Kallaba. "KF Bashkimi ka arritur akordin për bashkëpunimin me lojtarin që ishte pjesë e historisë, Blend Kallaba. Blendi shpirtin luftarak dhe dashurinë për KF Bashkimi do ta shfaqë në fushën e lojës. Në ditët në vazhdim do të ketë surpriza të tjera të këndshme", thuhet në njoftimin e skuadrës së Bashkimit. Të martën kjo skuadër e ka prezantuar edhe sulmuesin me përvojë të madhe, Nikollë Dushi.

### Ekipi i notit vazhdon garat në 'Baku 2019'

Olt Kondiroli dhe Vigan Bytyqi garuan në 100 metra stil i lirë, ndërsa Hana Fejzullahu në 400 metra stil i lirë. Olti pati kohën 56.57 sekonda, ndërsa Vigan 57.88 sekonda. Të dy garuan në të njëjtën bateri dhe zunë vendet pesë (Kondiroli) dhe shtatë (Bytyqi). Hana pati kohën 5 minuta e 5.07 sekonda. Koha e tyre nuk ishte e mjaftueshme për t'u kualifikuar tutje. Notarët do t'i vazhdojnë garat në disiplina të tjera edhe në tri ditët e ardhshme.

### Eminhaziri te Liria

Sulmuesi i njohur në Kosovë, Isa Eminhaziri, është prezantuar te skuadra e Lirisë së Prizrenit. "Isa Eminhaziri do të jetë pjesë e klubit. Ish-lojtari i shumë klubeve të Superligës: Vëllaznimit, Gjilanit, Drenicës, KEK-ut dhe Feronikelit si dhe ne Superiore e Shqipërisë: Besa e Kavajës dhe Teutën e Durrësit", thuhet në njoftimin e Lirisë. Skuadra nga Prizreni në edicionin e ri do të bëjë gara në Ligën e Parë të Kosovës në futboll.

## U21-shat kërkojnë fitore ndaj Argjentinës

**PRISHTINË, 23 KORRIK** - Barazimi ndaj Bahrejnit ka ndikuar që atmosfera në përfaqësuesen e juniorëve në hendboll të jetë edhe më e mirë. "Dardanët" të martën paradite kanë zhvilluar stërvitje në Pontevedra dhe janë të gatshëm për ndeshjen

me Argjentinën që e luajnë të mërkurën nga ora 9:45. Rinor Avdulli ka treguar formë në Spanjë, ndërsa ndaj Bahrejnit shënoi dy golat e fundit. "Stërvitja shkoi mirë dhe atmosfera po shkon vetëm duke u përmirësuar. Të gjithë lojtarët e dimë se çka munde-

mi dhe presim fitore me angazhim të madh ndaj Argjentinës. Duam ta mposhtim Argjentinën dhe të luajmë më pas për vendin 21. Pas barazimit do ta japim maksimumin për fitoren e parë në botëror", ka deklaruar Avdulli.



## Arifi lë Kosovën për Shqipërinë

PRISHTINË, 23 KORRIK - Karateisti Orges Arifi tash e tutje do ta përfaqësojë Shqipërinë në karate. Ai njoftoi ditë më parë se do të heqë dorë nga përfaqësimi i Kosovës, por nuk ka treguar arsyet.

Një prej karateistëve më të mirë kosovarë ka njoftuar se do t'i mbrojë ngjyrat e Shqipërisë, vend të cilin e kishte përfaqësuar edhe në të kaluarën. "Zyrtarisht kam marrë njoftimin pas

kërkesës sime që ta përfaqësoj Shqipërinë në garat e ardhshme ndërkombëtare. Një sfidë e re për t'i mbrojtur përsëri ngjyrat e flamurit kuq e zi", ka shkruar Arifi në "Facebook".



# Shorti, i pamëshirshëm për Prishtinën

PRISHTINË, 23 KORRIK - Në Munchen të Gjermanisë është hedhur shorti për grupet e FIBA Europe Cup Women, ku për herë të parë do të marrë pjesë edhe kampionia e Kosovës, KBF Prishtina. Prishtina do të jetë në një grup shumë të vështirë së bashku me dy skuadrat ruse, Sparta & K Moscow Region Vidnoje, MBA Mosow dhe Beshiktashin e Turqisë. Dy ekipet e para kualifikohen tutje. Sidoqoftë, kjo do të jetë një përvojë e mirë për vashat e Prishtinës të marrin pjesë në një garë të nivelit të tillë. Të pranishëm nga Klubi i Prishtinës në short kanë qenë përfaqësuesja e klubit Vlora Braha dhe trajneri Fidan Shatri. Kjo është hera e parë që një klub kosovar merr pjesë në gara ndërkombëtare, që pas sezonit 2003/2004 kur Universiteti i Prishtinës ka garuar në Ligën Rajonale Trocal. Ndashja e parë për vashat prishtinase do të jetë më 16 tetor në udhëtim te MBA Mosow, derisa ndeshjen e parë në shtëpi do ta kenë ndaj Spartas më 24 tetor. Më 31 tetor e presin Beshiktashin, si dhe më pas e presin MBA Moscow më 7 nëntor. Dy ndeshjet e fundit do të



jenë si mysafirë, ndaj Spartas më 27 nëntor dhe 5 dhjetor ndaj Beshiktashit. Dy ekipet e para kualifikohen tutje. Sidoqoftë, kjo do të jetë një përvojë e mirë për vashat e Prishtinës të marrin pjesë në një garë

të nivelit të tillë. Kjo është hera e parë që një klub kosovar merr pjesë në gara ndërkombëtare, që pas sezonit 2003/2004 kur Universiteti i Prishtinës ka garuar në Ligën Rajonale Trocal.

# Nadali: Dua të luaj më pak dhe të pushoj më shumë



Madrid, 23 korrik - Tenisti Rafael Nadal, në një intervistë për "Marca", ka deklaruar se me kalimin e viteve ai ka ndryshuar shumë në përballimin e situatave të ndryshme ku është gjetur. "Kur duelon në të tilla nivele, jo gjithçka është e bukur. Gjithsesi, kemi shumë persona afër që na ndihmojnë, në shumë aspekte", ka thënë spanjoli, numri 2 në botë.

"Ndonjëherë duhet të përballësh me momente të ndërlikuara dhe ke pak kohë të kalosh me familjen e miqtë. Ndaj, gjatë javëve pushim përpiqesh t'i shijosh në maksimum mundësitë që të krijohen. Kur isha i ri, pas një humbje, doja të kthehesha menjëherë në fushë por, tani jo. Kam nevojë të pushoj më shumë", ka shtuar Nadal. "Tani kam mësuar t'i

menaxhoj më mirë situatat. Ky është një sport individual, por nëse nuk bashkëpunon si duhet me stafin atëherë gjithçka bëhet e vështirë", ka deklaruar Nadal, 18 herë fitues i grand slamit. Spanjoli do të rikthehet në fushë në turneun e Montrealit, në javën e parë të gushtit e më pas do të luajë në Sinsinati dhe US Open.

### SHKURT

#### Muriqi: Dua ta vendos emrin tim me shkronja të arta te Fenerbahçe

Sulmuesi i Kosovës, Vedat Muriqi, po vazhdon ta tregojë klasën e tij edhe te skuadra e re. Tashmë te Fenerbahçe, Muriqi ka shënuar tri gola në dy ndeshje. Pas ndeshjes ndaj Wolfsburgut, ku Muriqi shënoi golin e vetëm për skuadrën e tij, ka deklaruar: "Fillimisht, unë mendoj se jam ambientuar shumë mirë te Fenerbahçe që kur kam ardhur. Shumë prej lojtarëve i njihja edhe më parë, shokët e skuadrës më kanë ndihmuar shumë. Dua të vendos emrin tim me shkronja të arta këtu. Kam ardhur pikërisht për këtë gjë".

#### Bale nuk largohet nga Reali

Deklaratat e radhës së trajnerit Zinedine Zidane për Gareth Bale kanë gjetur menjëherë përgjigjen e agentit të tij. Ai i ka habitur të gjithë duke thënë se uellsiani dhe mund të qëndrojë në "Santiago Bernabeu" nëse nuk gjendet diçka që i përshtatet klubit. "Gareth është një nga futbollistët më të mirë botë. Mund t'ju siguroj se nuk do të huazohet në një klub tjetër. Ai është lojtari i Realit dhe do të jetë kështu në vazhdim. Nëse kemi diçka që na përshtatet, gjërat mund të ndryshojnë në ditët ose javën në vazhdim. Ai mund të qëndrojë te Reali për tre vjetët në vazhdim, deri në përfundim të kontratës së tij", ka thënë agjenti i Bales.

#### City kërkon Mbappen, PSG-ja i ofron kontratë të re

Manchester City është duke u përpjekur që ta transferojë sulmuesin e Paris Saint Germainit, Kylian Mbappe. Gazeta franceze "El Pais" zbulon se 20-vjeçari pëlqehet nga skuadra e Premierligës, kurse trajneri Pep Guardiola ka mbajtur kontakte të rregullta me Mbappen në vitet e fundit. Mirëpo kampionët e Francës nuk po qëndrojnë duarkryq dhe i kanë ofruar yllit të tyre një kontratë të re prej 860 mijë funtesh në javë.

#### Fekiri në Betis

Nabil Fekir edhe zyrtarisht është transferuar në ekipin e Real Betisit. Fekir zgjodhi Betisin para klubeve të mëdha evropiane si Napoli dhe Arsenalit. Ish-sulmuesi i Lyonit zgjodhi të mos luajë në Ligën e Kampionëve për sezonin e ardhshëm pasi Real Betisi sezonin e kaluar përfundoi në vendin e dhjetë. Real Betisi arriti ta transferojë Fekirin për 17.5 milionë euro.

#### City dhe Barça nuk e bindin Alaban të largohet nga Bayerni

Pavarësisht interesimit nga Manchester City dhe Barcelona, David Alaba po planifikon të mos largohet nga Bayern Munchen. "Bild" raporton se mbrojtësi austriak është i vendosur që të luajë edhe për një sezon për skuadrën më të madhe gjermane. 27-vjeçari është pjesë e Bayernit nga viti 2010, kurse për një edicion ishte i huazuar në Hoffenheim. Alaba karrierë ka bërë edhe në ekipet e të rinjve të SV Aspern dhe Austria Wien.



Republika e Kosovës

Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti



Komuna e Prizrenit

Opština Prizren – Prizren Belediyesi

DREJTORIA KOMUNALE E ARSIMIT NË PRIZREN

Nr.2192/2019

Datë 24.07.2019

Në bazë të nenit 8 të Ligjit të punës nr. 03/L -212, neni 35 të ligjit për arsimin parauniversitar në Republikën e Kosovës me nr. 04/L-032, neni 5 të Ligjit për arsim në Komunitet dhe Republikës së Kosovës nr. 03/L-068, UA nr. 10/2018 – Normativit mbi kuadrin profesional të arsimit të përgjithshëm, udhëzimit administrative nr 07/2017 për rregullimin e procedurave për themelimin e marrëdhënieve të punës në sektorin publik, Drejtoria Komunal e Arsimit shpall:

### KONKURS

Pozita: Pesë (5) Asistent/c për fëmijët me nevoja të veçanta në nivelin e Drejtorisë Komunale për arsim

Paga mujore: 397.01 euro

Përgatitja shkollore: Shkolla e mesme dhe niveli i 5-të (post sekondar) i kualifikimit, asistent për fëmijët/ nxënësit me nevoja të veçanta arsimore.

Kohëzgjatja e kontratës: deri më 31.08.2020 me mundësi vazhdimi

Punët dhe detyrat për asistent/c për fëmijët me nevoja të veçanta arsimore

- ✓ Ndihmon fëmijët/ nxënësit në zhvillimin dhe promovimin e pavarësisë, orientim dhe mobilitet, transport, pozitën dhe uljen e nxënësit në klasë;
- ✓ Punon me mësimdhënësit dhe stafin tjetër për zbatimin e PIA-së, lëndë të individualizuara ose mësim në fusha të aktiviteteve;
- ✓ Përgadit material mësimor si dhe menaxhon me pajisjet e nevojshme brenda dhe jashtë klasës;
- ✓ Vëzhgon dhe dokumenton vështësitë dhe nevojat e identifikuar të fëmijëve, përgadit informata kthyese për vështësitë dhe arritjet e fëmijëve
- ✓ Promovon arsimin gjithëpërfshirës dhe pranimin e të gjithë fëmijëve në klasë, inkurajonë fëmijët në komunikim, për pjesëmarrje në lojë dhe stimulimin e të folurit dhe të gjuhës përmes bisedës dhe lojës;
- ✓ Mbikqyr dhe ndihmon fëmijët/ nxënësit gjatë racioneve ushqimore, kujdeset për nevojat fizike dhe mjekësore të nxënësve dhe asiston në veshje dhe pastërtinë e përgjithshme të tyre
- ✓ Planifikon me mësuesin/mësuesit programin ditor dhe javor për mësim, aktivitetet dhe ngjarjet me qëllim të mbështetjes së fëmijëve për mësim
- ✓ Promovon bashkëpunim shkollë/shtëpi, mbështetë dhe diskuton çështje të ndjeshme me prind/kujdestarin;
- ✓ Respekton rregullat dhe etikën e shkollës, sjelljet e mira ndaj nxënësve;
- ✓ Prezanton punën dhe arritjet e nxënësve. Informacionet në shkollë i trajton si plotësisht konfidenciale;

Dokumentacioni i nevojshëm për konkurim:

- Formulari i aplikimit (kerkesat) të cilën e plotëson kandidati
- Diploma ose Certifikatën e diplomës së kualifikimit të nivelit të pestë (5-të) PEARSON kopjen e vertetur
- Ekstrakt i lindjës
- Letërnjoftimin (fotokopje)
- Certifikata që nuk jeni nën hetime të Policisë së Kosovës

Dokumentet e kompletuara dorëzohen të fotokopjuara, ndërsa dokumentet origjinale prezantohen në intervistë. Dokumentet e pa kompletuara dhe ato që arrijnë pas afatit nuk merren në shqyrtim nga komisioni. Aplikacionet merren dhe dorëzohen në Zyrën e pranimit të dokumentacioneve, në Komunën e Prizrenit.

Afati i konkurimit 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga data 24.07.2019 deri më 07.08.2019.

Drejtori i DKA-së

Gani Gërmizaj



REPUBLIKA E KOSOVËS  
KUVENDI KOMUNËS-MALISHEVË



Zyra e Personelit  
Nr.01/1019  
Më:22/07/2019

Në mbështetje të dispozitave të nenit 11, të Ligjit për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, neni 15 dhe 17 të Rregullores Nr. 02/2010, për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, Udhëheqësi i Personelit shpall:

### KONKURS Për plotësimin e vendit të punës

I. DREJTORIA PËR SHENDETËSI DHE MIRËQENJE SOCIALE

1.(Një) Zyrtar për Mirëqenie Sociale 4,në QPS-Malishevë  
Kualifikimi i kërkuar: Bachelor -drejtimi Ekonomik, Juridik, apo ndonjë drejtim që lidhet me këtë vende të punës

Përvoja e punës: 4 vite përgatitje profesionale.

Koeficienti: 6.5

Kodi i vendit të punës MSK/080

Numri i referencës: RN00005278

Përshkrimi i detyrave të punës:

1. Planifikimi financiar dhe buxhetor për QPS
2. Menaxhimi i mjeteve financiare të alokuar
3. Mbajtja,plotësimi i dosjeve personale të punëtorëve dhe inventarizimit në QPS
4. Projektit i QPS-për avancim profesional-trajnime në fusha të ndryshme
5. Projektet për investime kapitale afatgjata
6. Bashkëpunon me shërbimet tjera brenda QPS –SNS ,SHSP
7. Parashikimi i rasteve e ndihmave momentale në bashkëpunim me K. Komunal
8. Planifikimi i shpenzimeve për QPS

Dokumentet e Kërkuara

-Diploma e përgatitjes profesionale;

-Letërnjoftimi (fotokopje);

-certifikata e lindjes;

-certifikata për trajnimet e kryera;

-Dëshmi që nuk është nën hetime

-Vërtetimin e përvojës së punës;

Të gjithë të interesuarit që dëshirojnë të aplikojnë në këto vende të punës janë të obliguar që t'i marrin dhe dorëzojnë aplikacionet në **Zyrën për pritim dhe palëve të KK- Malishevë**. Aplikantët janë të obliguar që t'i parashirojnë edhe këto dokumente: diplomën e shkollimit,Vërtetimin mbi përvojën në punë.

Konkursi do të mbetet i hapur 15 ( pesëmbëdhjetë ) ditë nga data e shpalljes së tij në të përditshme: "Epoka e re" dhe në tabelë të shpalljeve të **KK- Malishevë**.

Për intervistë do të njoftoheni me kohë.

**Udhëheqësi i Personelit**  
Gani Bahtjaraj, jur.dip.

#### Kërkesa për shprehje të interesit Emri i shkollës: "Vëllezërit Frashëri"

Komuna: Skenderaj

Data: 24.07.2019

Numri i kontratës:	Emri i kontratës:
ESIP/SDG/121-CS/1.3	Trajnim: Gjithëpërfshirja

Qeveria e Kosovës ka marrë një kredi nga grupi i Bankës Botërore për realizimin e projektit për përmirësimin e sistemit të arsimit (ESIP), dhe ka përqendrim që një pjesë të grantit ta përdor për ta përkrahur Ministrinë e Arsimit, të Shkencës dhe të Teknologjisë dhe **Shfmu "Vëllezërit Frashëri", Qubrel, Skenderaj**. Objektiv i nën-komponentit 1.2. (GZsh) të projektit ESIP është forcimi i kapaciteteve të shkollave që financohen me fonde publike që t'i planifikojnë dhe t'i menaxhojnë burimet si dhe ta promovojnë angazhimin qytetar përmes pjesëmarrjes së mësimdhënësve, prindërve dhe komunitetit në planifikimin, zbatimin dhe monitorimin e aktiviteteve të shkollës

Në kuadër të kësaj përkrahjeje do të realizohet prokurimi i shërbimeve të konsulentëve të nevojshme: Trajnim: Gjithëpërfshirja

Kualifikimet e firmës konsulente:

- Përvoja e suksesshme në ekzekutimin e kontratave për ofrimin e shërbimeve të konsulentëve të natyrës së ngjashme
- Përvojë në trajnimin e mësimdhënësve dhe personelin e shkollës
- Regjistrimi ligjor i firmës nga autoritetet vendore.

Firmat konsulente të pranueshme do të vlerësohen dhe radhiten në listën e ngushtë në bazë të kërkesave kualifikuese si më lartë.

Firmat konsulente duhet të tregojnë se kanë në dispozicion staf profesional, përkatësisht trajnerë të certifikuar dhe me përvojë në ofrimin e trajnimeve për mësimdhënës në fushën e gjithëpërfshirjes;

Kriteret e vlerësimit:

- Përvoja e suksesshme në ekzekutimin dhe zbatimin e kontratave për ofrimin e shërbimeve të konsulentëve nga fusha e gjithëpërfshirës (40%);
- Përvoja specifike në ofrimin e trajnimeve të natyrës së ngjashme apo gjithëpërfshirjes (40%);
- Disponueshmëria e personelit kyç profesional të kualifikuar për detyrat (20%)

Procesi i seleksionimit:

Aktiviteti i prokurimit të do të realizohet në përputhje me: Udhëzime: përzgjedhja dhe punësimi i konsulentëve nga huamarrësit e Bankës Botërore” të muajit janar 2011 dhe të rishikuara në korrik të vitit 2014, dhe me dispozitat e përcaktuara në marrëveshjen për financim, sipas përzgjedhjes të bazuar në metodën e Kualifikimeve të Konsulentëve (KK). Firmat Konsulente të interesuar që i plotësojnë kriteret minimale për kualifikim, të cekura më lartë, janë të mirëseardhura të aplikojnë me Shprehjet e tyre të Interesit për shërbime konsulente në adresën: **Shfmu "Vëllezërit Frashëri", Qubrel, Skenderaj, më së largu deri më datën; 01.08.2019**. Firmat e interesuara të konsulentëve mund të marrin informacion shtesë ose Termat e Referencës të detajuar për këto detyra në adresën e shënuar më poshtë.

**Detajet kontaktuese të shkollës:**  
**Personi kontaktues: Florim Rrustemi**  
**Telefoni: 044/194-633**  
**E-maili: florumrustemi@live.com**  
**E-mail: fehnikuqanaj@hotmail.com**



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
**Qeveria - Vlada - Government**

Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale - Ministarstvo za Rad i Socijalne Zaštite Ministry of Labour and Social Welfare

Mbështetur në nenin 13 dhe 18 të Ligjit Nr. 03/L - 149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, dhe në Rregulloren Nr. 02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil, Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, shpall:

### KONKURS

**Titulli i punës: Udhëheqës i Zyrës së Pensioneve**

Referenca : RN00005282

Koeficienti : 8 (tetë)

Kategoria funksionale: Niveli drejtues

Orari i punës: I plotë, 40 orë në javë

Akt Emërimi: Sipas Ligjit për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës

Procedura e aplikimit: I jashtëm

I përgjigjet: Udhëheqësit të Divizionit për Monitorim dhe Kontroll të Zyrave të Pensioneve

Vendi : Zyra e Pensioneve Ferizaj

**Qëllimi i vendit të punës:** Udhëheqja, organizimi, mbikëqyrja dhe operacionalizimi i zbatimit të kërkesave për skema pensionale në shkallë të parë të përcaktura me akte ligjore dhe nënligjore në Departamentin e Pensioneve dhe Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale.

**Detyrat dhe Përgjegjësitë:**

1. Udhëheqje, organizon, mbikëqyrë, planifikon dhe kontrollon zbatimin praktik të ligjeve të aprovuara nga sfera e pensioneve dhe beneficioneve;
2. Udhëheqjen e mbështetë në harmoni me trendet e organizimit bashkëkohor duke aplikuar parimet, konceptet, metodat e qarta për strategjinë zhvillimore të qendrës rajonale të pensioneve;
3. I udhëheq dhe i kontrollon të gjitha procedurat në lidhje me implementimin sa më efikas të skemave të pensioneve dhe beneficioneve, identifikon kërkesat e zyrës të pensioneve dhe kujdeset për realizimin e tyre;
4. Udhëheqjen e mbështet në dhënien dhe artikullimin e qartë të qëllimeve duke i përcaktuar mjetet, metodat, bartësit e kryerjes së të drejtave dhe detyrimeve në të gjitha fazat e procedimit si nismëtare, vendimarrëse, përmbartëse apo ekzekutuese;
5. Kujdeset për pranimin, evidentimin e aplikacioneve, kërkesave, ankesave si dhe dërgimin në zyrën qendrore të departamentit të pensioneve;
6. Përgatitë planin e punës, parashih nevojën buxhetore të zyrës dhe ndihmon departamentin e pensioneve në hartimin e akteve si dhe ndihmon në realizimin e tij;
7. Përgatitë raporte javore, mujore, tremujore, gjashtëmujore dhe vjetore për punën e zyrës së pensioneve;
8. Kryen punë të tjera sipas rekomandimit të udhëheqësit të divizionit.

**Kualifikimi, përvoja e punës, aftësitë dhe shkathtësitë tjera :**

Diplomë universitare në ekonomi, drejtësi apo shkenca tjera shoqërore.  
 Përvojë pune profesionale 4 vjeçare.  
 Të ketë aftësi të shkëlqyeshme drejtuese.  
 Aftësi për të motivuar, organizuar dhe mbikëqyrë personelin.  
 Aftësi të planifikoi dhe organizoi punën.  
 Aftësi për të gjykuar dhe vendimarrëse.  
 Aftësi për të punuar në grup dhe sjellje të shkëlqyer kolegjiale.  
 Shkathtësi kompjuterike në aplikacione të programeve (Word, Excel, Power Point, Access).  
 Njohja e gjuhëve zyrtare që fliten në Kosovë.

**Titulli i punës: Zyrtar për Pensione** (1 pozitë)

Referencë: RN00005280

Kategoria funksionale: Niveli profesional

Koeficienti: 6.5

Orari i punës: I plotë 40 orë në javë

Akt Emërimi: Sipas Ligjit për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës

Procedura e aplikimit: I jashtëm

I përgjigjet: Udhëheqësit të Zyrës së Pensioneve

Vendi : Zyra e Pensioneve në Prizren

**Qëllimi i vendit të punës:** Zbatimi i të gjitha procedurave administrative të bazuara në dispozitat ligjore që kanë të bëjnë me skemat pensionale.

**Detyrat dhe kryesore:**

1. Ofron informata dhe ndihmë për palët;
2. Pranon dhe protokolon kërkesat dhe ankesat për të gjitha skemat pensionale;
3. Bënë regjistrimin e kërkesave të pranuar për pensione nga të gjitha skemat pensionale në bazën e të dhënave të sistemit integruar informativ;
4. Kryen të gjitha procedurat që kanë të bëjnë me lajmërimin, suspendimin, riaktivizimin dhe riaplikimin e pensionistëve;
5. Bënë sistemimin dhe arkivimin e dokumentacionit në hapësirat përkatëse;
6. Bënë shpërndarjen e vendimeve për të gjitha skemat pensionale;
7. Përgadit të gjitha raportet e nevojshme nga fushëveprimi i zyrtarit të pensioneve;
8. Kryen punë të tjera administrative të ngarkuara nga mbikëqyrësi i tij (udhëheqësi i zyrës së pensioneve).

**Kualifikimi, përvoja e punës, aftësitë dhe shkathtësitë tjera:**

Diplomë universitare në Drejtësi, Ekonomi dhe Shkenca Sociale pa përvojë pune ose Shkollë e lartë me dy (2) vjetë përvojë pune në fushën administrative dhe teknike ;  
 Shkathtësi kompjuterike të aplikacioneve të programeve (Word, Excel, Power Point, Access);  
 Aftësi për punë nën presion dhe si pjesë e ekipit;  
 Gatishmëri për të i'u shërbyer të gjitha komunitetve pa dallim.

**Titulli i punës: Zyrtar për Pensione** (1 pozitë)

Referencë: RN00005281

Kategoria funksionale: Niveli profesional

Koeficienti: 6.5

Orari i punës: I plotë 40 orë në javë

Akt Emërimi: Sipas Ligjit për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës

**Procedura e aplikimit: I jashtëm**

**I përgjigjet : Udhëheqësit të Zyrës së Pensioneve**

**Vendi: Zyra e Pensioneve në Shtërpce**

**Qëllimi i vendit të punës:** Zbatimi i të gjitha procedurave administrative të bazuara në dispozitat ligjore që kanë të bëjnë me skemat pensionale.

**Detyrat dhe kryesore:**

1. Ofron informata dhe ndihmë për palët;
2. Pranon dhe protokolon kërkesat dhe ankesat për të gjitha skemat pensionale;
3. Bënë regjistrimin e kërkesave të pranuar për pensione nga të gjitha skemat pensionale në bazën e të dhënave të sistemit integruar informativ;
4. Kryen të gjitha procedurat që kanë të bëjnë me lajmërimin, suspendimin, riaktivizimin dhe riaplikimin e pensionistëve;
5. Bënë sistemimin dhe arkivimin e dokumentacionit në hapësirat përkatëse;
6. Bënë shpërndarjen e vendimeve për të gjitha skemat pensionale;
7. Përgadit të gjitha raportet e nevojshme nga fushëveprimi i zyrtarit të pensioneve;
8. Kryen punë të tjera administrative të ngarkuara nga mbikëqyrësi i tij (udhëheqësi i zyrës së pensioneve);

**Kualifikimi, përvoja e punës, aftësitë dhe shkathtësitë tjera:**

Diplomë universitare në Drejtësi, Ekonomi dhe Shkenca Sociale pa përvojë pune ose Shkollë e lartë me dy (2) vjetë përvojë pune në fushën administrative dhe teknike ;  
 Shkathtësi kompjuterike të aplikacioneve të programeve (Word, Excel, Power Point, Access);  
 Aftësi për punë nën presion dhe si pjesë e ekipit;  
 Gatishmëri për të i'u shërbyer të gjitha komunitetve pa dallim.

**Konkursi mbetet i hapur 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga dita e publikimit në shtypin ditor dhe në Sistemin Informativ për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore (SIMBNJ), nga data 24.07.2019 deri më 07.08.2019.**

**Formularët për aplikim merren në divizionin për burime njerëzore/MPMS dhe të plotësuara dorëzohen, çdo ditë pune nga ora 08:00-16:00, adresa: Rruga "Edit Durham" Nr. 46-Prishtinë, afër sheshit "Zahir Pajaziti" ndërtesa e MPMS-së. Aplikacioni mund të shkarkohet nga ueb-faqe <http://mpms-gov.net/>**

Aplikacionet e dërguara me postë të cilat mbajnë vulën postare mbi dërgesën ditën e fundit të afatit për aplikim do të konsiderohen të vlefshme nëse arrijnë brenda 4 (katër) ditësh. Aplikacionet e pakompletuara nuk do të shqyrtohen.

Aplikacionit i bashkangjiten kopje të dokumentacionit mbi kualifikimin, për përvojën e punës, dokumente tjera të nevojshme që kërkon vendi i punës për të cilën konkurrojnë kandidatët.

Kandidatët që ftohen në intervistë janë të obliguar të sjellin me vete dokumentet origjinale për verifikim para komisionit intervistues.

Kandidatët që hyjnë në përzgjedhje të ngushtë, do të informohen lidhur me intervistën nëpërmjet telefonit ose me shkrim në afat ligjor nga zyra e personelit..

Shërbimi Civil i Kosovës ofron mundësi të barabarta të punësimit për të gjithë shtetasit e Republikës së Kosovës dhe mirëpret aplikacionet nga të gjithë personat e gjinisë mashkullore dhe femrore nga të gjitha komunitetet në Kosovë .

Duke u bazuar në Ligjin Nr. 03/L-214 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, Neni 20, pika 2 dhe 4, Kompania "Sedtours" Sh.p.k Prizren, në bashkëpunim me Ministrin e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, organizojnë:

### DEBAT PUBLIK

Për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për bazën e betonit në Reçan komuna e Prizrenit.

Njoftohet publiku i interesuar se më datën 20.08.2019 në ora 13:00 në lokalet e kompanisë "Sedtours" Sh.p.k., rruga "Remzi Ademaj" Nr. 34 Prizren do të organizohet debat publik nga kompania "Sedtours" Sh.p.k Prizren, në bashkëpunim me Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor.

Debati publik do të organizohet për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për bazën e betonit në Reçan komuna e Prizrenit.

Pjesëmarrja e juaj na ndihmon në implementimin e projektit.



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**

Qeveria - Vlada - Government  
Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale - Ministarstvo za Rad i Socijalne Zaštite Ministry of Labour and Social Welfare

Na osnovu članova 13 i 18 Zakona br. 03 / Z-149 o Civilnoj Službi Republike Kosovo, i Uredbi br. 02/2010 o Procedurama Rekrutovanja u Civilnoj Službi, Ministarstvo Rada i Socijalne Zaštite objavljuje:

**KONKURS**

**Naziv rada: Rukovodioc Penzijske Kancelarije**

**Referencija: RN00005282**

**Koeficijent: 8 (osam)**

**Funkcionalna kategorija: Rukovodeći Nivo**

**Radno vreme: Puno, 40 sati nedeljno**

**Akt Imenovanja: Prema Zakonu o Civilnoj Službi Republike Kosova**

**Postupak prijave: Spoljni**

**Izveštava: Rukovodiocu Divizije za Nadzor Kancelarija za Penzije**

**Mesto: Penzijske Kancelarije Urosevac**

**Namena radnog mesta:** Upravljanje, organizovanje, nadzor i operacionalizaciju primene zahteva za penzijske šema u prvom stepenu definisano sa zakonima i propisima departman penzije i MRSZ.

**Zadaci i odgovornosti:**

- Upravlja, organizuje, nadgleda, planira i kontroliše praktičnu primenu usvojenih zakona iz oblasti penzija i beneficija;
- Rukovodstvo vodi uz podrške u skladu sa trendovima savremenog organiziranja uz primenom načela, konceptima, jasnom metodom za razvojnom strategijom regionalnog centra penzije;
- Upravlja i kontroliše sve procedure koje se odnose na efikasnoj primeni penzijskih šema beneficija, identifikuje potrebe regionalne kancelarije za penzije i stara se za njihovu realizaciju;
- Upravljanje podržava u pružanju i jasne artikulacije ciljeva definisanih, sredstava metoda, nosioci obavljanja prava i obaveza u svim fazama postupka kao: inicijalne, odlučivanja, izvršne;
- Stara se za prijem i evidentiranje aplikacija, zahteva, žalbi i kao i dostavljanje u centralnu kancelariju departman za penzije;
- Priprema plan rada, predviđa budžetskih potreba kancelarije i pomaže direktoru u realizaciji istih;
- Priprema nedeljne, mesečne, kvartalne, polugodišnje i godišnje izveštaje o radu regionalnih centara za penzije;
- Obavlja i drugih zadataka pod predloga rukovodioca divizije.

**Kvalifikacije, radno iskustvo, veštine i druge veštine:**

Visoka stručna sprema iz oblasti ekonomije ili prava, i društvenih nauka.

4 godine radnog iskustva u struci.

Imati odlične sposobnosti upravljanja.

Sposobnost da motiviše, organizuje i nadgleda osoblje.

Sposobnost da planira i organizuje rad.

Sposobnost prerasuda i donošenje odluka.

Sposobnost za rad u grupi i odličnim kolegijalnim ponašanjem.

Računarske veštine u softverskim aplikacijama (Word, Excel, Power Point, Access)

Poznavanje službenih jezika koji se govore na Kosovu.

**Naziv Radnog mesta: Službenik za Penzije** (1 pozicija)

**Reference: RN00005280**

**Funkcionalna kategorija: Profesionalni nivo**

**Koeficijent: 6.5**

**Radno vreme: punih 40 sati nedeljno**

**Akt o imenovanju: Prema Zakonu o Civilnoj Službi Republike Kosovo**

**Postupak prijave: Spoljni**

**Odgovoreno: Rukovodiocu Kancelarije za Penzije**

**Mesto: Penzijske Kancelarije u Prizren**

**Svrha radnog mesta:** Implementacija svih administrativnih procedura zasnovanih na zakonskim odredbama koje se odnose na penzijske šeme.

**Glavni zadaci**

- Pružanje informacija i pomoći stranama;
- Prihvata i obrađuje zahteve i pritužbe za sve penzijske šeme.
- Registruje primljene penzijske zahteve iz svih penzijskih šeme u bazu podataka informacionog integracionog sistema;
- Obavlja sve postupke u vezi sa obaveštavanjem, suspenzijom, reaktivacijom i ponovnim reaktivacijom penzionera;
- Postavljanje sistematizacije i arhiviranje dokumentacije u odgovarajućim prostorima;
- Raspodela odluka za svim penzijskim šemama;
- Priprema sve potrebne izvještaje iz delokruga službenika za penzije;
- Obavlja i druge administrativne poslove zahtevanih od njegovog rukovodioca penzijske kancelarije.

**Kvalifikacija, radno iskustvo, veštine i druge veštine:**

Univerzitetsku diploma pravnog, ekonomskog fakulteta i društvenih nauka, bez radnog iskustva ili Visa škola sa dve (2) godine radnog iskustva u administrativnoj i tehničkoj oblasti;

Sposobnosti za kompjuterske aplikacije (word, Excel, Power Point, Access);

Veština za rad pod pritiskom i kao deo tima;

Spremnost služiti svim zajednicama služiti svim zajednicama bez razlike.

**Naziv Radnog mesta: Službenik za Penzije** (1 pozicija)

**Reference: RN00005281**

**Funkcionalna kategorija: Profesionalni nivo**

**Koeficijent: 6.5**

**Radno vreme: punih 40 sati nedeljno**

**Akt o imenovanju: Prema Zakonu o Civilnoj Službi Republike Kosovo**

**Postupak prijave: Spoljni**

**Odgovoreno: Rukovodiocu Kancelarije za Penzije**

**Mesto: Penzijske Kancelarije u Sterpce**

**Svrha radnog mesta:** Implementacija svih administrativnih procedura zasnovanih na zakonskim odredbama koje se odnose na penzijske šeme.

**Glavni zadaci**

- Pružanje informacija i pomoći stranama;
- Prihvata i obrađuje zahteve i pritužbe za sve penzijske šeme.
- Registruje primljene penzijske zahteve iz svih penzijskih šeme u bazu podataka informacionog integracionog sistema;
- Obavlja sve postupke u vezi sa obaveštavanjem, suspenzijom, reaktivacijom i ponovnim reaktivacijom penzionera;
- Postavljanje sistematizacije i arhiviranje dokumentacije u odgovarajućim prostorima;
- Raspodela odluka za svim penzijskim šemama;
- Priprema sve potrebne izvještaje iz delokruga službenika za penzije;
- Obavlja i druge administrativne poslove zahtevanih od njegovog rukovodioca penzijske kancelarije.

**Kvalifikacija, radno iskustvo, veštine i druge veštine:**

Univerzitetsku diploma pravnog, ekonomskog fakulteta i društvenih nauka, bez radnog iskustva ili Visa škola sa dve (2) godine radnog iskustva u administrativnoj i tehničkoj oblasti;

Sposobnosti za kompjuterske aplikacije (word, Excel, Power Point, Access);

Veština za rad pod pritiskom i kao deo tima;

Spremnost služiti svim zajednicama služiti svim zajednicama bez razlike.

**Konkurs ostaje otvoren 15** (petnaest) dana od dana objavljivanja u dnevnoj štampi, u Informacionom Sistemu za Upravljanje Ljudske Resurse, (ISULJR) od **24.07.2019** do **07.08.2019**

**Obrazi za prije uzeti u Diviziji Ljudskim Resursima MRSZ u prizemlje, i popunjene dostavljati, svakog radnog dana od 08:00 do 16:00 časova. Adresa: Ulica "Edit Durham" u blizini, trga "Zahir Pajaziti" zgrada MRSZ-te u Prištini, aplikacija se može preuzeti sa <http://mpms-gov.net/>**

Aplikacije koje su poslate poštom koja drže poštanski žig na pošiljci poslednjeg dana roka za prijavu smatraće se važećim ako dostignu u roku od 4 (četiri) dana. Aplikaciji dostaviti kopije kvalifikacione dokumentacije, radno iskustvo i druga neophodna dokumenta koja zahteva radno mesto za koje kandidati konkurisu. Nepotpune aplikacije neće biti pregledane.

Kandidati pozvani na intervju su obavezni da sa sobom donesu originalnu dokumentaciju za verifikaciju pred komisijom za intervju.

Kandidati koji ulaze u bliskoj selekciji će biti obavješteni o intervju telefonom ili pismenim putem u zakonskom roku od kancelarije osoblja.

Kosovska Civilna Služba nudi jednake mogućnosti zapošljavanja za sve građane Republike Kosovo i pozdravlja prijave svih polova muškaraca i žena iz svih zajednica na Kosovu.

**>> SHPALLJE TË VOGLA <<**

► Fitim Gashi shpall te pavlefshme dëftesat e kl I - IV, drejtimi tek ekonomi dhe diplomën e SHMT "Anton Çetta" Skenderaj.

► Ajet Shala, shpall te pavlefshme diplomën e shkollës fillore "Lirija" Turiqevc, Skënderaj.

► Arbenit Musliu shpall të pavlefshme Dëftesën për kryerjen e shkollës së mesme te ulet (kl. VI, VII, VIII , IX) "Ahmet Delija " Skenderaj .

► Sefer Hysen Shyti me nr. personal 1004883213 shpallë të pavlefshme certifikatën e veteranit Invalid të UÇK-së, të lëshuar nga Komisioni Qeveritarë për njohjen dhe verifikimin e statusit të dëshmorit të kombit invalidit veteranit pjesëtarit apo të internuarit të luftës së UÇK-së.

► Dekoral Aluminyum San Va Tic A.S- Kosovo Branch dega në Kosovë shpallë të pavlefshme certifikatën e biznesit me nr. 70882086 me nr fis. 600865680

► Urgjentisht kërkoj një banesë me qera ne Prishtine. Banesa duhet të ketë 1 ose 2 dhoma gjumi e mobiluar ose bënë edhe e pa mobiluar. Çmimi prej: 200-250 €. Tel: 045-660-188

► Lëshoj lokalin më qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit: 049-392-275

► Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanët me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139

► Shitet banesa në Lakërishte përballë Procredit Bankës, hyrja e parë kati i 9 banesa ka 50m2 me dokumentacion të rregullt, çmimi 52 000€. Për info 044/672-439.

► Lëshohet me qira banesa në lakërishtë afër ProcREDIT bankës është e mobiluar 50m2 për një çift çmimi është 220€. Për irno 044/672-439.

► Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkone. Për info 044/332-640.

► Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra Qerimi2, i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkone. Për info 044/332-640.

► Lëshoj banesën me qira e cila gjendet prapa AAK-së me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e tel: viber +37744162783 dhe 049/900-994.

► Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.

► Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.

► Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.

**KONKURS****EDUKIDS NË FERIZAJ, SHPALL KONKURS:**

- Edukatore - 3 vende të lira;
- Motër Edukatore - 3 vende të lira;
- Kuzhinierë - 1 vend i lirë;
- Pastruese - 1 vend i lirë.

**Për të qenë pjesë e EduKids në Ferizaj, ju duhet t'i plotësoni këto kushte dhe kritere:**

- Edukatore dhe motër edukatore  
Të keni të kryer Fakultetin e Edukimit (Drejtimi Parashkollor, Pedagogji);  
Të keni të kryer Shkollën e mesme të mjekësisë - Drejtimi i Përgjithshëm;  
Drejtimi i Pediatrisë; Drejtimi Mamisë ose edhe Fakultetin e Mjekësisë - Drejtimi Infjermeri (vlen vetëm për motër edukatore);  
Përvojë pune;  
Të keni aftësi të shkëlqyera komunikative për të krijuar raporte ndërpersonale me fëmijët;  
Të jeni persona të besueshëm, të përgjegjshëm, fleksibël, te motivuar, energjikë dhe emocionalisht të gatshëm për t'u përballuar me situata emergjente;  
Të njihni mirë psikologjinë dhe botëkuptimin e fëmijeve;  
Të jepni ndihmën e parë në rastet emergjente.

- **Kuzhinierë**

- Të keni të përfunduar shkollimin e mesëm si dhe përvojë pune së paku 2 vite;  
Të keni aftësi të shkëlqyera komunikative për të krijuar raporte ndërpersonale me stafin dhe fëmijët;  
Të jeni persona të besueshëm, të përgjegjshëm, fleksibël, te motivuar dhe energjikë.

- **Pastruese**

- Të keni të përfunduar shkollimin e mesëm si dhe përvojë pune së paku 2 vite;  
Të jeni persona të besueshëm, të përgjegjshëm, fleksibël, te motivuar dhe energjikë.

**Kandidatet e interesuara duhet të kompletojnë dokumentet:**

- CV;
- Diploma dhe çertifikatat e trajnimeve (nëse keni);
- Dëshmitë mbi punët paraprake (nëse keni punuar më herët);
- Çertifikata e lindjes.

Të gjitha këto dokumente duhet të dërgohen në adresën: edukids05@gmail.com  
Për info shtesë, kontaktoni EduKids +383 45 714 713 (viber&whatsApp)  
**KONKURSI MBETET I HAPUR DERI MË 31 KORRIK 2019**

Vetëm kandidatet e kualifikuara do të ftohen për intervistë

**KONKURS**

- Edukatore** - 3 vende të lira
- Motër Edukatore** - 3 vende të lira
- Kuzhinierë** - 1 vend i lirë
- Pastruese** - 1 vend i lirë

CV-të e kompletuara me dokumentet e kërkuara  
të dërgohen në: [edukids05@gmail.com](mailto:edukids05@gmail.com) deri në datën **31 Korrik 2019**

Për info shtesë, kontaktoni: **+383 45 714 713**

